



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë  
Prezenca në Shqipëri**

**Departamenti i Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut**



**PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN  
E NJË GJYKIMI TË DREJTË**

**RAPORT I PERIUDHËS**

*tetor 2003 – korrik 2004*

**Angelika WINGENFELD  
Drejtuese e Projektit për Prokurorinë/Gjykatat**

---

*Shtator 2004*

## Përmbajtja e lëndës

<b>A. HYRJE.....</b>	<b>fq. 3</b>
<b>B. PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>fq. 4</b>
<b>C. STRUKTURA E PROGRAMIT.....</b>	<b>fq. 6</b>
<i>I. Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.....</i>	<i>fq. 6</i>
<i>II. Statistika.....</i>	<i>fq. 8</i>
<b>D. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT .....</b>	<b>fq. 8</b>
<b>E. ANALIZE LIGJORE .....</b>	<b>fq. 10</b>
<b><i>I. Seancat .....</i></b>	<b><i>fq. 10</i></b>
1. Mjedisi .....	fq. 10
2. Aksesit për informacion.....	fq. 14
3. Prania e pjesëmarrësve.....	fq. 19
4. Kohëzgjatja e procesit.....	fq. 22
5. Sjellja profesionale e palëve në gjykim .....	fq. 24
6. Siguria dhe rendi publik.....	fq. 26
7. Dëshmitarët .....	fq. 29
8. Media .....	fq. 31
<b><i>II. Vendimet gjyqësore.....</i></b>	<b><i>fq. 32</i></b>
1. Arsyetimi ligjor .....	fq. 32
2. Vlerësimi i llojit dhe masës së dënimit .....	fq. 34
<b><i>III. Llojet veprave penale të gjykuara .....</i></b>	<b><i>fq. 35</i></b>
<b>F. REFLEKTIME PËR ÇËSHTJET E KRIMIT TË ORGANIZUAR.....</b>	<b>fq. 36</b>
<b><i>I. Statistika.....</i></b>	<b><i>fq. 36</i></b>
<b><i>II. Studim çështjesh.....</i></b>	<b><i>fq. 36</i></b>
<b><i>III. Veçanti të çështjeve të trafikimit të drogës.....</i></b>	<b><i>fq. 38</i></b>
<b>G. REKOMANDIME .....</b>	<b>fq. 38</b>
<b>H. PERSPEKTIVA .....</b>	<b>fq. 41</b>

## A. HYRJE

Korrupsioni shihet si një nga pengesat kryesore të sistemit gjyqësor në Shqipëri. Studime dhe analiza të ndryshme të gjyqësorit kanë treguar se gjykatat janë perceptuar gjërësisht nga publiku si institucionet më të prekura nga ky fenomen. Kjo u konfirmua nga një studim i kryer nga Iniciativa për Zhvillimin Ligjor e Evropës Juglindore (SELDI), sipas të cilit korrupsioni përfshin të gjithë aktorët e sistemit gjyqësor, përkatësisht gjykatësit, prokurorët, administratën dhe avokatët. Për më tepër, dobësia e sistemit gjyqësor është një nga pikat kryesore të shqetësimit të bashkësisë ndërkombëtare dhe për pasojë pengon përparimin e Shqipërisë në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, i cili është deklaruar nga qeveria si një prioritet kryesor.<sup>1</sup> Synimi i këtij studimi nuk është të përcaktojë nëse ka korrupsion në gjyqësorin shqiptar, sesa të evidentojë faktin se besimi i publikut tek gjyqësori është i ulët si dhe të japë sugjerime në mënyrë që puna e gjykatave të jetë më e frytshme, me qëllim rritjen e këtij besimi.

Nevoja për rritjen e besimit të qytetarëve të sistemi gjyqësor ishte një nga arsyet që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nisi Programin për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë. Mandati i Prezencës bën thirrje - *inter alia* - për ndjekjen nga afër të reformës ligjore dhe gjyqësore. Në zbatim të elementëve të mandatit për të mbështetur një qeverisje të mirë dhe ndërmarrjen e veprimtarive antikorrupsion, një pjesë e punës së Departamentit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut është që të ndihmojë për rritjen e kapaciteteve të institucioneve të sektorit ligjor, në veçanti për të inkurajuar institucionet që të krijojnë rregulla për arritjen e niveleve më të larta të transparencës. Në përputhje me angazhimet e lartpërmendura në fushën e zbatimit të ligjit, qëllimi i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë është rritja e transparencës në praktikën gjyqësore dhe rritja e standarteve të gjykimit (si ato ndërkombëtare dhe ato të brendshme).

Programi dy-vjeçar është i ndarë në dy faza. Gjatë fazës së parë të programit u vëzhgua shkalla e parë për çështjet e krimeve të rënda (d.m.th. vrasje, krime trafikimi, vjedhje me armë), fillimisht në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe më pas në Gjykatën për Krime të Rënda me vendndodhje në Tiranë, e cila filloi punë më 1 janar 2004. Ndërkohë, gjatë fazës së dytë programi do të zgjerohet duke shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut (si p.sh. dhuna në familje, drejtësia për miturit, të drejtat e pakicave) si dhe çështje të tjera me rëndësi për zhvillimin e demokracisë (si p.sh. shpërdorim detyre, mitmarrja). Kjo fazë do të kërkojë vëzhgimin e çështjeve jo vetëm në Tiranë, por edhe në Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Shkodër dhe Kukës. Formularët standartë që do të plotësohen nga vëzhguesit pas përfundimit të çdo gjyqi, vendimet gjyqësore të marra nga gjykata, si dhe intervista shpesh të bëra me gjykatësit, prokurorët dhe avokatët mbrojtës, përbëjnë themelin e analizës. Konstatimet përmbledhen në raporte vëzhgimi të përpiluara çdo gjashtë javë. Veç këtij raporti të ndërmjetëm, do të hartohet

<sup>1</sup> Raporti i Stabilizimit dhe Asociimit i vitit 2004 i Komisionit Europian për Shqipërinë vë në dukje se "një shqetësim i veçantë janë çështjet që lidhen me zbatimin e ligjit. Këto përfshijnë luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor". Zyra e Departamentit të Shteteve të Bashkuara për Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe Punën, konkludon në raportin e saj për Shqipërinë për vitin 2003 se "për shkak të presionit politik, frikësimit, korrupsionit endemik, mitmarrjes dhe burimet e kufizuara, një pjesë e madhe e gjyqësorit nuk ishte në gjendje të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe efçente". Për shkak të "predominimit në rritje të nënshtrimit të shtetit" të shkaktuar nga lidhje të krimit të organizuar me zyrtarë publikë, Freedom House në raportin e vet të vitit 2004, Kombet në Tranzicion, vendosi që ta ulë vlerësimin e korrupsionit të Shqipërisë nga 5.00 në 5.25. Shërbimet shëndetësore, doganat dhe gjyqësori përmenden si sektorët në të cilët korrupsioni është më shumë i përhapur.

një raport përfundimtar pas fazës së dytë të programit, me qëllimin për plotësimin e një analize më të gjerë të administrimit të drejtësisë, duke përfshirë një vlerësim të kualifikimeve dhe funksionimit të gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe personelit tjetër të drejtësisë, e cila do të shërbejë si një mjet për pajisjen e Prezencës me të dhëna për formulimin e strategjive të reformës ligjore.

## **B. PËRMBLEDHJE**

Vëzhgimi i çështjeve të krimeve të rënda u krye gjatë një periudhe nëntëmujore dhe prandaj nuk pretendon që të japë një pamje të plotë të zbatimit të standarteve të gjyqimit të drejtë në gjyqësorin shqiptar. Aq më tepër që objekt i fazës së parë të programit ishin vetëm gjykatat e ndodhura në Tiranë. Megjithatë, analiza pasqyron problemet kryesore me të cilat përballet gjyqësori aktualisht në Shqipëri.

Një nga këto probleme lidhet me të drejtën për një gjykim publik. Para së gjithash, seancat nuk kryhen gjithmonë në sallat e gjykatës, por disa herë zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve. Kjo praktikë krijon probleme për hapësirën dhe prandaj efektivisht kufizon numrin e vëzhguesve, që mund të ndjekin një seancë gjyqësore. Megjithëse vëzhguesve në parim nuk iu mohua hyrja në seancat gjyqësore, paafësia për të respektuar afatet për shkak të vonesave të ndryshme, shoqëruar me mungesë informacioni nga ana e personelit të gjykatës, e bënë mjaft të vështirë ndjekjen e një çështjeje nga fillimi deri në fund.

Një pjesë e madhe e vonesave shkaktohet nga masat e pamjaftueshme për transportimin e të pandehurve që janë nën masën e sigurimit arrest në burg. Pavarësisht nga transferimi në vazhdim i përgjegjësive nga Ministria e Rendit Publik tek Ministria e Drejtësisë, deri tani nuk mund të raportohen përmirësime të dukshme në lidhje me transportin. Pasojat e orëve të pritjes për pjesëmarrësit në një proces gjyqësor janë të shumta. Prokurorët dhe avokatët mbrojtës i humbasin orët e punës të cilat mund t'ua kushtonin çështjeve të tjera, dëshmitarëve u duhet ta zgjasin kohën në kushte të parehatshme për shkak të mungesës së një dhome pritjeje – një fakt që i ekspozon ata ndaj hakmarrjes së personave të afërt me të pandehurin.

Të pandehurit e gjykuar në gjendje të lirë shkaktojnë shtyrje, meqenëse është i vështirë vërtetimi i njoftimit të saktë për shkak të mungesës së një sistemi të plotë dhe të azhurnuar të regjistrit civil. Kryerja e saktë e njoftimeve është e domosdoshme për deklarimin e të pandehurit në mungesë nga ana e gjykatës, në mënyrë që të procedohet me çështjen dhe të sigurohet që të pandehurit e tjerë, veçanërisht ata që mbahen në paraburgim, të gjykohen brenda një kohe të arsyeshme. Shtyrje të tjera rezultojnë nga mosparaqitja e dëshmitarëve për të njëjtën arsye. Meqenëse zakonisht ka një hapësirë prej dhjetë ditësh ndërmjet seancave të një gjyqi, ky i fundit mund të zgjasë lehtësisht disa muaj; aq më tepër që seancat zakonisht janë relativisht të shkurtëra. Proceset më të gjata janë ato që përfshijnë akuzat për trafikim droge dhe trafikim të qënieve njerëzore. Këto çështje shpesh kanë disa të pandehur, fakt ky që i bën ata tepër të ndjeshëm ndaj shtyrjeve, duke konsideruar edhe kohën që shpenzohet lidhur me procedurat për ndihmën e ndërsjelltë juridike për shkak të natyrës së këtij aktiviteti kriminal, i cili i kapërcen kufijtë.

Gjykimi në mungesë i një të pandehuri ose i një pjese të të pandehurve ndodh shpesh, duke çenuar kështu të drejtën e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjyq. Bie shumë në sy, veçanërisht në çështjet e bujshme, që në bankën e të akuzuarit nuk ulen kriminelët kryesorë, por të dyshuar të vegjël të akuzuar për veprimtari mbështetëse. Duke patur parasysh këtë fakt,

deklarata e Ministrit të Rendit Publik Igli Toska më 23 shtator, sipas së cilës arritjet e policisë së shtetit në vitet e fundit përfshijnë kapjen e kriminelëve të krimeve të rënda, duket e kontestueshme, ngaqë ata që veprojnë prapaskene, me sa duket, kanë bashkëpunëtorë brenda radhëve të policisë, çka u mundëson atyre që t'i shpëtojnë në kohë ndjekjes penale.

Shumicës së të pandehurve të gjykuar në mungesë avokati u gjendet nga familja dhe nuk caktohet nga gjykata. Në përgjithësi, avokatët e mbrojtjes rrallë caktohen nga gjykata. Avokatët e mbrojtjes të caktuar nga gjykata kanë treguar më pak përpjekje në paraqitjen e një çështjeje, në krahasim me ata që zgjidhen nga i pandehuri ose familja e tij. Niveli profesional i ish-gjyqtarëve, të ashtuquajtur "gjashtëmujor", të cilët tani janë bërë avokatë, ka rezultuar tepër i dobët.

I diskutueshëm është numri i lartë i proceseve të kryera në kuadrin e gjykimeve të shkurtuara për të miturit ose për të pandehurit me probleme mendore, sepse ata mund të mos kenë një mendim të qartë lidhur me pasojën që vjen nga zgjedhja e një procedure të tillë, që është një reduktim i provave në seancë gjyqësore dhe si rrjedhojë një kufizim i strategjive të mbrojtjes. Kështu, rekomandohet që këto grupe të pandehurish të përjashtohen nga gjykimet e shkurtuara.

Ambienti i sallave të gjyqit nuk i plotëson nevojat e pjesëmarrësve, veçanërisht lidhur me kushtet e hapësirës për gjyqe ku numri i të pandehurve apo avokatëve mbrojtës është i madh. Mënyra e sistemimit të vendeve të uljes e bën të pamundur komunikimin midis të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës gjatë seancës. Për më tepër, pozicioni i dëshmitarëve gjatë pyetjes dëmton parimin e barazisë së armëve.

Masat për mbrojtjen e dëshmitarëve kryesisht nuk zbatohen, përveç ndonjë shoqërimi nga oficerë të policisë gjyqësore në gjyq për rastet kur është bërë një kërkesë më parë nga zyra e prokurorisë. Përveç mungesës së dhomës së pritjes, që përmendëm tashmë, nuk ka hyrje/dalje të veçantë për dëshmitarët, ndërkohë që kur trupi gjykues tërhiqet për konsultim dëshmitari lihet në sallën e gjyqit ballëpërballë me autorët e krimit. Më tej, pyetja e dëshmitarëve "problematikë" për shkak të nivelit të tyre të ulët arsimor, shqetësimeve mendore apo traumave të pësuarra, nga ana e gjyqtarëve ndonjëherë nxjerr në pah një mungesë ndjeshmërie, dhe si pasojë, nuk mund të grumbullohet informacioni i nevojshëm që lidhet me provat. Së fundi, publikimi pa asnjë kufizim i çështjeve gjyqësore nga ana e medias duke përfshirë edhe zbulimin e emrave të dëshmitarëve, regjistrimin e deklarimeve të bëra dhe fotografitë e botuara rrezikojnë sigurinë e dëshmitarëve si dhe atë të pjesëmarrësve të tjerë në gjykim (policisë, prokurorëve) dhe për më tepër dëmton vendosjen e drejtësisë nga ana e gjykatës. Kjo përkeqësohet nga fakti se për shkak të standarteve të ulta profesionale të gazetarëve si dhe ndjekjes në mënyrë jo të plotë të çështjeve nga ana e tyre nuk jepet gjithmonë një tablo e vërtetë e përmbajtjes së seancave.

Për shkak të mungesës së kuadrit (nën)ligjor si dhe të mungesave të komunikimit midis gjyqësorit nga njëra anë dhe policisë nga ana tjetër, nuk zbatohen standarte të unifikuara sigurie. Kontrolli tërësor në hyrje i vëzhguesve që marrin pjesë në gjykim si dhe vëmendja që i kushtohet ruajtjes së rendit publik në sallën e gjyqit varet plotësisht nga personaliteti i policëve në shërbim. Përfaqësuesit e medias, pavarësisht nga mospërfillja e shpeshtë e udhëzimeve të sigurisë, zakonisht trajtohen me butësi për shkak të lidhjeve miqësore. Kjo madje në një çështje çoi në përplasje midis gjykatësit që kryesonte seancën dhe një polici, ngaqë ky i fundit shpërfilli udhëzimet e të parit.

Rreziqet, që lidhen me sigurinë e mjedisit të gjykatës për shkak të këtyre shqetësimeve me personelin e policisë, shtohen nga mospërdorimi i mjeteve të tilla si detektorët metalikë, videokamerave si dhe kasafortave për ruajtjen e dosjeve dhe provave materiale. Në parim, çdo njeri mund të hyjë në zyrat e personelit të gjykatës, ku dokumentet nuk janë të kyçura dhe kështu mund të humbasin lehtësisht. Pavarësisht nga fakti se kohët e fundit në Gjykatën e Rrethit Tiranë është instaluar një detektor metalik si dhe videokamera, këto mjete megjithëse në dukje funksionale, nuk përdoren.

Në lidhje me të drejtën e gjykimit nga një gjykatë kompetente, të pavarur, të paanshme dhe të krijuar me ligj, duhet vënë në dukje se kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve kanë qenë tepër të rralla. Kërkesa më e shpeshtë që bëhet nga mbrojtja lidhet me mosvënien në dispozicion të të gjithë dosjes, me qëllim shtyrjen e seancës në mënyrë që të fitohet kohë për studimin e saj. Në të tilla raste gjykata priret ndaj miratimit të kërkesës dhe për pasojë proceset zgjaten.

Vonesa të tjera rezultojnë prej mungesës së ekspertëve. Me futjen e metodave të reja, të sofistikuar të hetimit, si dhe me kërkesën në rritje për ekspertizë psikiatrike e psikologjike, në sajë edhe të amendamenteve të legjislacionit për drejtësinë e të miturve dhe të një numri në rritje të personave të varur nga droga, nuk ka specialistë të mjaftueshëm në dispozicion për të kryer ekzaminimet e nevojshme në kohën e duhur.

Meqenëse aktualisht nuk ka as ligj të veçantë as ndonjë akt nënligjor unifikues, që të specifikojë se si u caktohen çështjet gjyqtarëve,<sup>2</sup> gjykata të ndryshme kanë metoda të ndryshme. Kështu, mund të bëhen lehtë manipulime në mënyrë të atillë që gjyqtarëve t'u jepen çështjet për të cilat ata mund të japin konkluzione në favor të njërës palë. Për pasojë rrezikohet parimi i paanësisë.

Së fundi, vendimet gjyqësore nuk pasqyrojnë se si i arriti konkluzionet gjykata. Kjo lidhet në mënyrë të veçantë me fazën e shqyrtimit provave, që ndonjëherë kthehet thjesht në një numërim të mjeteve të marrjes së provave, dhe në vlerësimin e masës së dënimit. Gjykata duhet të marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese që kanë të bëjnë jo vetëm me veprën penale, por edhe me gjendjen e të pandehurit dhe qëllimin e dënimit. Në fakt, dy faktorët e fundit shtjellohen rrallë, gjë që bën që dënimi i dhënë të mos jetë i individualizuar.

## **C. STRUKTURA E PROGRAMIT**

### **I. Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë**

Megjithëse Ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese"<sup>3</sup> zëvendësoi Kushtetutën e fundit komuniste, struktura organizative dhe veprimtaritë e gjykatave mbetën kryesisht të pandryshuara me përjashtim të dispozitave që shkaktonin mospërputhje me legjislacionin e ri. Megjithatë, Ligji Nr. 7561 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr. 7491, datë 29 prill 1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" përmbante amendamentet kryesore, që iu bënë Kushtetutës së përkohshme në lidhje me sistemin gjyqësor. Për shembull, u krijuan Gjykata Kushtetuese dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, një organ ekzekutiv që mbikqyr gjykatat e nivelit

<sup>2</sup> Një ligj i tillë përcaktohet në nenin 15 të Ligjit Nr. 8436, i datës 28 dhjetor 1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

<sup>3</sup> Ligji Nr. 7491, i datës 29 prill 1991.

të ulët. Ligje të tjera u miratuan pas trazirave të vitit 1997 si dhe u themelua shkolla e parë pasuniversitare për trajnimin e magistratëve, e ashtuquajtura Shkolla e Magistraturës.

Në Shqipëri ekzistojnë tri pushtete, përkatësisht legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori. Neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës së Shqipërisë thotë se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kushtetuta parashikon një sistem gjykatash me tri nivele, që janë Gjykatat e Shkallës së Parë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë.<sup>4</sup> Në përputhje me numrin e rretheve gjyqësore në vend, ekzistojnë 29 gjykata të rregullta të shkallës së parë<sup>5</sup> dhe gjashtë gjykata të rregullta të apelit.<sup>6</sup> Këto të fundit dëgjojnë apelimet nga gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e tyre. Çështjet shqyrtohen nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, ndërsa në lidhje me gjykatat e shkallës së parë, si çështjet civile dhe ato penale dëgjohen ose nga një gjykatës ose nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, në bazë të llojit të çështjes.<sup>7</sup> Në total janë caktuar 276 – 295 gjyqtarë në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe 49 – 50 në Gjykatat e Apelit.

Gjykata e Lartë është e vetmja gjykatë në Shqipëri, e cila ka juridiksion origjinal si dhe rishikues. Çështjet e juridiksionit origjinal janë akuzat ndaj Presidentit të Republikës, Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, anëtarëve të Parlamentit, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe çështjet e paraqitura nga gjykatësit për raste largimi kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Përsa i përket pjesës tjetër, Gjykata e Lartë ka juridiksion apelues. Në lidhje me këtë, ajo trajton thjesht apelimet për çështje legjislacioni. Vendimet për këto, në përgjithësi merren nga një trup gjykues prej pesë gjyqtarësh. Në Gjykatën e Lartë punojnë 17 gjyqtarë.

Përveç gjykatave të zakonshme, janë ngritur gjykata speciale të cilat janë Gjykatat Ushtarake dhe, kohët e fundit,<sup>8</sup> Gjykata për Krime të Rënda dhe Kolegji Zgjedhor. E para trajton çështjet sipas Kodit Penal Ushtarak dhe apelimet dëgjohen nga Gjykata Ushtarake e Apelit.<sup>9</sup> Gjykata për Krime të Rënda ka juridiksion që lidhet me krijimin e bandave të armatosura, krijimin e organizatave kriminale, drejtimin e organizatave kriminale, krimet e kryera nga këto grupime, vjedhjet me armë dhe çdo krim që ndëshkohet me jo më pak se 15 vjet burg.<sup>10</sup> Këto çështje apelohe në Gjykatën e Apelit për krimet e rënda. Të dyja gjykatat ndodhen në Tiranë, por mbulojnë të gjithë territorin e Shqipërisë. Aktualisht 11 gjyqtarë<sup>11</sup> janë emëruar në Gjykatën

<sup>4</sup> Neni 135-147 i Kushtetutës

<sup>5</sup> Dekreti i Presidentit Nr.2110, i datës 29 Maj 1998: Tiranë, Krujë, Kurbin, Mat, Mirditë, Bulqizë, Dibër, Durrës, Kavajë, Elbasan, Librazhd, Gramsh, Shkodër, Lezhë, Pukë, Tropojë, Kukës, Korçë, Pogradec, Kolonjë, Vlorë, Fier, Skrapar, Lushnjë, Berat, Gjirokastër, Sarandë, Përmet, Tepelenë.

<sup>6</sup> Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë, Gjirokastër.

<sup>7</sup> Neni 13, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale vendos se gjykatat e rretheve dhe ato ushtarake gjykojnë me një trup gjykues të përbërë nga tre gjykatës, kur trajtohen krimet dhe nga një gjyqtar dhe dy ndihmës gjyqtarë kur trajtohen kundërvajtjet penale.

<sup>8</sup> Gjykata për Krime të Rënda filloi të operojë më 1 Janar 2004, Neni 11, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 9110 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda".

<sup>9</sup> Neni 9, 10 i Ligjit Nr. 8436 "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

<sup>10</sup> Sipas Nenit 5, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 9110 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda", datë 24 Korrik 2003, në lidhje me Nenin 75a të Kodit të Procedurës Penale.

<sup>11</sup> Duke përfshirë kryetarin dhe zëvendëskryetarin.

për Krime të Rënda<sup>12</sup> dhe 8 gjyqtarë<sup>13</sup> në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda për një afat 9-vjeçar të rinovueshëm.<sup>14</sup>

Kolegji Zgjedhor u krijua në kuadrin e kodit të ri zgjedhor të miratuar në vitin 2003 me qëllim trajtimin e çështjeve zgjedhore. Neni 163 i Kodit Zgjedhor parashikon një hedhje shorti midis gjyqtarëve të apelit në të gjithë vendin për të vendosur se kush do të shërbejë në Kolegjin Zgjedhor.

Gjykata Kushtetuese është një gjykatë e veçantë jashtë sistemit të zakonshëm gjyqësor që ka kompetencën për të vendosur për kushtetueshmërinë e ligjeve. Ajo gjithashtu mund të marrë vendime për dëmshpërblime për çështje të caktuara individuale, përkatësisht pretendimeve për shkeljet e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Pasi janë ezauruar të gjitha rrugët e tjera ligjore, mund të paraqitet një kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese.

## II. Statistika

Në lidhje me cilësinë e statistikave që disponojmë, duhet theksuar se për shkak të hyrjes në fuqi të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale në vitin 1995, të ndryshimeve të mëpasme në Legjislacionin Penal, si dhe të ndryshimeve në treguesit statistikorë që lidhen me ndjekjen penale, shifrat nuk mund të krahasohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Megjithatë, procedimet penale të regjistruara në Prokurorinë e Përgjithshme u ulën nga 14,641 në 1993 në 7,472 në 1998. Me përjashtim të vitit 2000, numri i çështjeve u rrit në mënyrë të vazhdueshme deri në 11,173 në vitin 2003. Rreth gjysma e çështjeve të reja të regjistruara gjatë këtij viti, përkatësisht 5,794, u dërgua në gjykatë. Në 2000, krimet e rënda siç quhen sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, 423 çështje u raportuan në Ministrinë e Drejtësisë, 445 për vitin 2001 dhe 262 për vitin 2002. Është vënë re se informacioni i dhënë nga Ministria e Drejtësisë nuk përputhet me shifrat e Prokurorisë së Përgjithshme, sepse Prokuroria e Përgjithshme raportoi 510 krime të rënda për vitin 2000, 487 për vitin 2001, 578 për vitin 2002 dhe 407 për vitin 2003. Ngarkesa me çështje e gjykatave në të gjithë vendin ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga rrethi në rreth, p.sh., Përmeti regjistroi 34 ndjekje penale në 2002 ndërsa Shkodra regjistroi 373.

Bie në sy se vetëm 81 akuza u paraqitën në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda gjatë gjysmës së parë të vitit 2004, që do të thoshte një reduktim i konsiderueshëm në numrin e çështjeve të krimeve të rënda. Prandaj kjo kërkon një shqyrtim nga afër, nëse ky reduktim është për shkak të ndryshimeve brenda strukturës organizative, d.m.th. krijimit të organeve të krimeve të rënda brenda prokurorisë dhe gjyqësorit apo një rezultat i ndryshimeve në shpërndarjen e krimeve. Numri i 200 çështjeve të hetuara nga Prokuroria për Krime të Rënda në gjashtë mujorin e parë të vitit 2004 flet për supozimin e mësipërm.

## D. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë filloi në verën e vitit 2003, bazuar në të metat e sistemit të drejtësisë penale shqiptare, të cilat u konstatuan gjatë përgatitjes së Raportit të

<sup>12</sup> Në të ardhmen e afërt planifikohet një zgjerim, shiko pikën H.

<sup>13</sup> Duke përfshirë kryetarin dhe zëvendëskryetarin.

<sup>14</sup> Neni 3 i Ligjit Nr. 9110 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda".



Prezencës "Analizë e Sistemit Ligjor në Shqipëri".<sup>15</sup> Shkurtimisht këto të meta janë mënyra e emërimit të gjyqtarëve në postet e larta, administrimi i çështjeve në prokurori dhe gjykata, mungesa e një publikimi të rregullt dhe sistematik të vendimeve gjyqësore, sistem i pamjaftueshëm kontrolli të brendshëm i performancës dhe sjelljes etike të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe një ndjekje penale e kufizuar e krimeve të rënda.<sup>16</sup>

Programi përbëhet nga dy faza,<sup>17</sup> njëra prej të cilave është përfunduar. Faza e parë u zbatua nga tetori 2003 deri në korrik 2004, ndërkohë që faza e dytë e programit do të fillojë në shtator 2004, pas pushimeve verore të gjykatës. Programi do të vazhdojë deri në dhjetor 2005, kur do të dalë edhe raporti përfundimtar.

Për shkak të burimeve njerëzore e materiale të kufizuara në dispozicion të prezencës së OSBE-së, është ndërmarrë një përafrim cilësor. Me fjalë të tjera, është vëzhguar vetëm një numër i përzgjedhur çështjesh. Megjithatë, ato janë ndjekur që prej seancës së hapjes e deri në shpalljen e vendimit. Kriteret e përzgjedhjes janë marrë sipas rëndësisë së çështjes ("çështjet e bujshme", krimi i organizuar) duke i matur në një farë mase edhe nga sasia e publicitetit që ato gjenerojnë, nga lloji i krimit për të marrë një model përfaqësues, marrëveshjet juridike apo faktike (psh. për ndihmën e ndërsjelltë juridike, për mbrojtjen e dëshmitarit, masat e veçanta hetimore) dhe ndjeshmërinë lidhur me të drejtat e njeriut (psh. të pandehurit e mitur, të pandehurit e sëmurë mendorë ose të pandehurit që janë pjesëtarë të pakicave etnike).

Gjatë periudhës tetor 2003 - mars 2004<sup>18</sup> u vëzhguan një total prej 204 seancash të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Tiranë lidhur me 38 procese.

Prej seancës së parë të Gjykatës për Krime të Rënda që u zhvillua më 10 shkurt 2004 deri në atë të fundit, para pushimeve të verës më 23 korrik 2004, një total prej 142 seancash u ndoqën nga vëzhguesit në kuadrin e 20 çështjeve. Nga këto, 7 janë përfunduar nga gjykata. Nga 20 procedime, 4 ishin për vrasje, 6 çështje të tjera për trafikim,<sup>19</sup> 4 për vjedhje me armë dhe 4 që lidheshin me krijimin e organizatave kriminale. Dy prej organizatave kriminale ishin të përfshira në trafikimin e drogës, njëra në trafikimin e fëmijëve dhe një tjetër në vrasje.

Pas përfundimit të çdo çështjeje objekt vëzhgimi, vëzhguesit plotësuan një pyetësor. Pyetësori është hartuar me mjaft hollësi, duke synuar shqyrtimin e aspekteve procedurale<sup>20</sup> si dhe detajet e një çështjeje. Ai i është përshtatur legjislacionit të brendshëm dhe praktikave të përdorura gjërësisht. Në mënyrë që të sigurohej një analizë që të provokonte ide dhe mendime, në këtë raport janë paraqitur edhe paragrafë shtesë që lidhen me karakteristikat e çështjeve të veçanta.

<sup>15</sup> Raporti "Analiza e Sistemit Ligjor në Shqipëri" përshkruan kuadrin ligjor dhe statusin organizativ të institucioneve kyçe të sektorit ligjor në mënyrë që të vlerësojë gjendjen e tij aktuale. Bazuar në rekomandimet e dhëna, duhen zhvilluar strategjitë e reformës në trajtën e projekteve. *Shih* Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri. *Analiza e Sistemit Ligjor në Shqipëri* (Tiranë: OSBE, 2004)

<sup>16</sup> Shih faqen 6 të Raportit të Komisionit Europian për Stabilizimin dhe Asociimin 2004.

<sup>17</sup> Për informacion më të detajuar shih pikën A.

<sup>18</sup> Çështja e parë e gjykuar në Gjykatën për Krime të Rënda, vrasja e Shefit të Komisarariatit të Krujës, Gani Malushi dhe shoferit të tij, Gjovalin Ndreu (më poshtë e quajtur si çështja Malushi) filloi në 10 shkurt 2004. Përveç një çështjeje të vrasjes me paramendim të filluar 2 javë më vonë, çështje të tjera pasuan në mars 2004. Për këtë arsye, në mars 2004 vëzhguesit u përqëndruan në Gjykatën për Krime të Rënda ndërkohë që në janar dhe shkurt 2004 vazhdonin të vëzhgonin çështjet e ndjekura në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

<sup>19</sup> Tri çështje përmbanin akuzën për trafikim të femrave për prostitucion, dy për trafikim fëmijësh dhe një për trafikim të qënieve njerëzore.

<sup>20</sup> Duke përfshirë një vlerësim të zotësisë së prokurorisë dhe të mbrojtjes, shkeljeve të prokurorisë dhe gjyqësorit, etj.

Meqenëse mandati i Prezencës nuk lejon akses të pakufizuar në dokumente si dhe në seancat e fazës para gjykimit, fokusi është faza e gjykimit.

Autorët e këtij studimi kanë krijuar gjithashtu një bazë të dhënash (Database), që përmban vendime për vendosjen e masave të sigurimit si dhe vendime gjyqësore, të cilat u janë kërkuar paraprakisht gjykatave. Kjo bazë të dhënash do të sistematizojë informacionin e mbledhur gjatë programit. Pyetësorët e plotësuar, vendimet gjyqësore dhe intervistat e bëra me prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët mbrojtës përbëjnë bazën e Raporteve të Vëzhgimit, të përpiluar një herë në gjashtë javë. Raportet vënë në dukje shkeljet e të drejtave të njeriut duke mbledhur, analizuar dhe sintetizuar faktet, por gjithashtu duke parë edhe perspektivën e respektimit të ligjit.

Ky trajtim i kombinuar synon të japë një informacion të saktë për sistemin gjyqësor në Shqipëri, veçanërisht lidhur me boshllëqet që ekzistojnë mes praktikës së zbatuar aktualisht dhe standarteve të brendshme e ndërkombëtare. Prandaj theksi është vendosur më shumë tek prirjet e konstatuara gjatë vëzhgimit sesa tek të metat e veçuara brenda sistemit. Rekomandimet praktike mendohet të identifikojnë fusha ku procedura gjyqësore mund të përmirësohet, për të cilën kërkohen trajnime ose reformë legislative. Për çështjet e bujshme me një interes të veçantë<sup>21</sup> janë përpiluar raporte të veçanta.

Në fazën e dytë të programit, stafi i Zyrave Rajonale të Prezencës, i ngarkuar me vëzhgimin e gjykatave të rretheve, do të udhëzohet për legjislacionin që i përket sistemit gjyqësor, prokurorisë si dhe për rolin e palëve gjatë fazës së hetimit dhe të gjykimit.<sup>22</sup> Gjithashtu, stafi do të informohet mbi programin për mbrojtjen e dëshmitarëve, mbi drejtësinë për të miturit, për minoritetet, trafikimin e qënieve njerëzore, të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe standartet e një gjykimi të drejtë, teknikat e monitorimit të gjyqit si dhe parimet bazë për vëzhguesit që kanë të bëjnë me sjelljen, konfidencialitetin dhe raportimin me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre. Fillimisht, Zyrat Rajonale kanë ndjekur në mënyrë rastësore disa seanca gjyqësore, për t'u familjarizuar me formularët standart.

## **E. ANALIZA LIGJORE**

### **I. Seancat**

#### **1. Mjedisi**

Pavarësisht se BE ka caktuar 5.000.000 Euro<sup>23</sup> për ndërtimin dhe ngritjen e një Gjykate për Krime të Rënda në kuadrin e Planit Kombëtar të Veprimet CARDS 2003, ndërtimet deri tani nuk kanë filluar. Gjykata e re do ta ketë vendndodhjen pranë burgut 313, në zonën periferike të Tiranës. Ndërkohë, për shkak të ankesave nga ana e zyrtarëve të gjykatave në lidhje me mungesën e hapësirës, është gjetur një zgjidhje e përkohshme, e cila parashikon rikonstrukcionin e një ndërtese që gjendet pranë vendndodhjes së ardhshme të mjediseve të reja.

<sup>21</sup> P.sh. për "çështjen Gromi", një çështje e trafikimit të organizuar të drogës, ose "çështjen Malushi", vrasja e Shefit të Komisarariatit të Krujës dhe shoferit të tij.

<sup>22</sup> D.m.th. policia, i pandehuri, mbrojtja, prokurorët, gjyqtarët.

<sup>23</sup> Sipas propozimit të projektit, kjo shumë përfshin instalimin e "pajisjeve bazë të Gjykatës". Nuk specifikohet se çfarë artikujsh konsiderohen për t'u futur në këtë kategori.

Nuk dihen ende hollësitë, as afatet, por duket se kjo lëvizje nuk ka për të ndodhur deri nga mesi i vitit 2005.<sup>24</sup>

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda aktualisht është në të njëjtën godinë me Gjykatën e Rrethit të Tiranës, kurse Gjykata e Apelit për Krime të Rënda është akomoduar në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Për këtë, ishin të domosdoshme marrëveshjet mes kryetarit të Gjykatës së Rrethit, të Apelit dhe Gjykatës për Krime të Rënda në lidhje me dhënien e hapësirave për zyra, përdorimin e sallave të gjyqit, transferimin e mobiljeve dhe pajisjeve të tjera të zyrave si dhe për masat e sigurisë.

Deri tani nuk është arritur asnjë rezultat i kënaqshëm nga përsa më sipër. Meqënëse vetëm një pjesë e katit të katërt të ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Tiranë i është dhënë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, hapësira e zyrave për stafin është e kufizuar, tre ose katër persona në një dhomë. Madje edhe kryetari duhet të rrijë në të njëjtën zyrë me sekretaren e tij. Kur ka takime konfidenciale, sekretarja duhet të largohet nga dhoma dhe për pasojë nuk mund të punojë gjatë kësaj kohe në tavolinën e saj.

Kancelari ka zyrën e tij në të njëjtin kat, por në anën tjetër të ndërtesës, aty ku ndodhen sallat e gjyqit. Në qoftë se kancelari do të komunikojë me pjesën tjetër të stafit ose në qoftë se do të bëjë një fotokopje apo të dërgojë një faks, atij i duhet të kalojë përmes një salle gjyqi. Por kjo vetëm nëse nuk zhvillohen gjyqe. Në të kundërt, atij i duhet të zbresë shkallët deri në katin e parë, pastaj të futet në hyrjen publike dhe të ngjisë shkallët përsëri deri në katin e katërt.

Natyrisht kjo procedurë merr shumë kohë, veçanërisht duke konsideruar që kancelarit, si shef i administratës, i duhet të komunikojë mjaft me personelin. Përveç kësaj, zyra e kancelarit është tepër e vogël dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të mbajtur të gjitha librat, dosjet dhe materialet e tjera me të cilat ai punon. Raftet, dollapet, tavolinat dhe karriket janë marrë hua nga institucione të tjera (kryesisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë), por nevojiten edhe pajisje të tjera. Këtu flitet në mënyrë të veçantë edhe për kasafortat kundër zjarrit, me qëllim ruajtjen e dosjeve si dhe provave materiale. Aktualisht këto lloje pajisjesh nuk janë të kyçura, prandaj pastrueset, punëtorët apo dhe vizitorët që hyjnë në zyra, mund t'i shikojnë këto dokumente dhe mundet madje edhe t'i marrin me vete në një moment kur njerëzit që ndodhen në zyrë nuk e kanë mendjen.

Për më tepër, në ndërtesën e Gjykatës<sup>25</sup> dhe në hyrjen e katit të katërt<sup>26</sup> nuk kryhen kontrole sigurie, kështu armët për të kërcënuar apo sulmuar personelin mund të futen brenda me lehtësi. Një anëtar i Gjykatës për Krime të Rënda madje deklaroi se një vizitor kishte hyrë një herë në zyrën e një gjykatësi dhe po sillej në mënyrë tepër agresive. Punonjësit e gjykatës nuk janë trajnuar për situata të tilla dhe në shumicën e seancave (d.m.th. seancat me të pandehur në paraburgim), nuk ka policë të pranishëm për të ruajtur zyrat e gjyqtarëve, megjithëse Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda"<sup>27</sup> në nenin 9 të tij thotë se gjyqtarët e gjykatës së krimeve të rënda gëzojnë mbrojtje të veçantë personale, familjare dhe pasurore, si dhe ruajtje të afërt fizike dhe neni 10 i ligjit të lartpërmendur përcakton se brenda 3

<sup>24</sup> Shih gjithashtu pikën H.

<sup>25</sup> Gjatë pushimeve të verës u instalua një detektor metalik në hyrje të ndërtesës ku ndodhen sallat e gjyqit.

<sup>26</sup> Vetëm një roje (një burrë në moshë, i paarmatosur) është vendosur pranë zyrës së kryetarit për të siguruar që asnjë të mos hyjë pa leje. Ky vëzhgim nuk është i vazhdueshëm nga që roja ndonjëherë është i zënë me detyra të tjera, bisedon me kolegët ose i duhet t'u përgjigjet kërkesave të vizitorëve.

<sup>27</sup> Ligji Nr. 9110, datë 24 korrik 2003.

muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji,<sup>28</sup> Këshilli i Ministrave ngarkohet për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore në lidhje me - *inter alia* - sigurimin e ruajtjes së posaçme të mjediseve të punës. Pavarësisht nga fakti se ka një vit që afati ka kaluar, këto rregullore nuk janë hartuar.

Deri tani të gjitha seancat<sup>29</sup> janë zhvilluar në dy salla gjyqi të cilat i janë caktuar për përdorim eksklusiv Gjykatës për Krime të Rënda. Njëra nga sallat e gjyqit ndodhet në katin e parë. Ajo është salla më e madhe në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe është e vetmja që ka një gardh metalik që ndan të pandehurit nga pjesëmarrësit e tjerë dhe vëzhguesit. Salla tjetër ndodhet në katin e katërt. Zakonisht seancat me një numër të madh të pandehurish/avokatë mbrojtës, si dhe me të pandehur që gjykohen nën masën e sigurimit arrest me burg, zhvillohen në sallën që ka siguri më të madhe, atë në katin e parë.

Megjithatë, edhe kjo sallë nuk është e përgatitur për gjyqe me më tepër se tre avokatë mbrojtës, duke konsideruar se tavolina e tyre ka vend vetëm për tre persona. Për gjyqet me më tepër se tre avokatë mbrojtës, nënpunësi gjyqësor zakonisht sjell karrike shtesë, të cilat mund të vendosen në një radhë të dytë ose vendosen si shtesë e tavolinës që tashmë ndodhet në sallë. Për pasojë, në rastin e parë, ata avokatë mbrojtës që janë ulur mbrapa kolegëve të tyre kanë një pamje të kufizuar të dëshmitarëve si dhe mundësi të kufizuara komunikimi me të pandehurit. Duke patur parasysh faktin që edhe për kolegët e tyre, të vendosur në radhën e parë, është mjaft e vështirë të flasin me të pandehurit, për shkak të pozicionit perpendikular të gardhit metalik, ndërkohë që tavolina e këshillimit të mbrojtjes është paralel me atë të gjyqtarëve, për këta avokatë që janë akoma më larg komunikimi me të pandehurit është pothuajse i pamundur.

Për më tepër dëshmitarët që thirren për të dëshmuar duhet të qëndrojnë në anën e majtë të sallës së gjyqit, d.m.th pranë tavolinës së prokurorit, në vend që të qëndrojnë midis prokurorit, mbrojtjes dhe gjykatës.<sup>30</sup> Meqënëse një dëshmitar mund të jetë i vetmi mjet i provës dhe për këtë arsye është vendimtar për rezultatin e procedimeve, edhe vështrimet apo gjestet mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e besueshmërisë së tij. Një vlerësim i tillë dëmtohet *de facto* nga një pamje e reduktuar dhe për më tepër parimi i barazisë së armëve vihet në rrezik. Ky parim që aplikohet si për procedimet civile dhe për ato penale do të thotë që çdo njeri që është palë në proces duhet të ketë një rast të arsyeshëm për të paraqitur çështjen e tij në gjykatë në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh thelbësor përballë kundërshtarit të vet.<sup>31</sup> Ndërkohë, në sallën e vogël gjyqësore të katit të katërt dëshmitarët i japin dëshmitë e tyre në mes të sallës përballë trupit gjykues, që do të thotë midis prokurorit dhe mbrojtjes. Tavinat e secilit prej tyre janë të vendosura perpendikularisht, që do të thotë që të dy janë në gjendje të shqyrtojnë fytyrën e dëshmitarëve.

Kur vendoset që për avokatët të shtohet një tavolinë në vazhdim, në vend që të vendoset një tavolinë në rradhën e dytë, nuk mbetet hapësirë e mjaftueshme për kalimin e nëpunësve gjyqësorë apo policëve të cilët vijnë si nga hyrja publike, ashtu edhe nga hyrja e personelit të gjykatës, gjë që ngre shqetësime të sigurisë. Nga pikëpamja e sigurisë, është i diskutueshëm gjithashtu fakti se salla e gjyqit në katin e katërt është e pajisur me pajisje që lëvizin lehtësisht, një fakt që i bën këto pajisje të predispozueshme si armë ose si pengesa në rastin e një arratisjeje të planifikuar nga ana e një të pandehuri.

<sup>28</sup> Ligji Nr. 9110, datë 24 korrik 2003.

<sup>29</sup> Përveç një seance që sidoqoftë u shty, sepse mungonte prokurori. Kjo seancë u zhvillua në sallën e gjyqit, fqinjë në katin e katërt.

<sup>30</sup> E parë nga dera e hyrjes së sallës.

<sup>31</sup> Condron kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2 maj 2000.

Një problem tjetër është akustika në sallën e katit të parë. Mikrofonat e instaluar për gjykatësit, prokurorët dhe mbrojtësit shumicën e kohës nuk punojnë. Të pandehurit dhe dëshmitarët nuk kanë fare mikrofon në dispozicion. Meqënëse dëshmitari qëndron në cepin e majtë të sallës, diagonal me sekretaren (e cila ndodhet në të djathtë të sallës), është e vështirë për këtë të fundit që të ndjekë procesin me qëllim që të mbajë procesverbalin. Situata përkeqësohet prej nivelit të lartë të zhurmës në sallën e gjyqit për shkak të hyrjeve e daljeve, si dhe bisedave të publikut dhe të medias.

Ndryshe nga kjo, salla në katin e katërt nuk është as sa gjysma e sallës në katin e parë kështu që probleme të akustikës nuk ka pasur. Nga ana tjetër, salla në katin e katërt nuk ka tavolinë të gjatë e të mjaftueshme në të cilën mund të ulen të gjithë gjyqtarët.<sup>32</sup> Por, meqënëse jo të gjithë anëtarët e trupit gjykues mbajnë shënime situata është e pranueshme. Zakonisht shënimet merren nga kryetari dhe nga një ose dy anëtarë të trupit gjykues, të cilët janë caktuar si *rapporteurs* përpara fillimit të gjyqit.

Në lidhje me sallat e gjyqit shpesh ka mospërputhje me listën e publikuar nga gjykata. Këto mospërputhje shpesh ndodhin prej seancave që vonohen të fillojnë për shkak se kërkojnë sistemim në një sallë të caktuar paraprakisht për një çështje tjetër. Meqënëse nëpunësit gjyqësor nuk janë në dijeni të zhvillimeve më të fundit ata u japin vëzhguesve informacion të gabuar në lidhje me sallën e gjyqit, p.sh. ka ndodhur që vëzhguesit që presin një gjyq me tetë të pandehur të drejtohen për në katin e katërt nga nëpunësi gjyqësor, megjithëse salla në katin e parë nuk ishte e zënë në atë kohë. Kur vëzhguesit ishin gati për të hyrë në sallën e katit të katërt, disa gazetarë dhe pjesëtarë të familjeve të të pandehurve ishin gati për të lëvizur në drejtimin e kundërt, pasi ishin informuar se gjyqi do të zhvillohej në sallën e gjyqit të katit të parë (çka ishte e vërtetë).

Ndryshe nga Gjykata e Rrethit Tiranë, në Gjykatën për Krime të Rënda vetëm një seancë u mbajt në zyrën e gjykatësit (në zyrën e kryetarit). Seanca në fjalë<sup>33</sup> ishte planifikuar të zhvillohej gjatë pushimeve verore të gjykatës,<sup>34</sup> por që në fillim ishte e qartë për pjesëmarrësit që ajo do të shtyhej, sepse gjykatës nuk i ishin bërë të njohura rezultatet e një ekspertize. Në Gjykatën e Rrethit Tiranë shumica e gjyqeve zhvilloheshin në zyrat e gjyqtarëve. Në parim, vetëm gjyqet me të pandehur nën masën e sigurimit arrest me burg ose gjyqet me më shumë se dy të pandehur, u zhvilluan në sallat e gjyqit.

Arsyet e qëndrimit në zyrë duket se janë të një natyre praktike: para së gjithash, është më e përshtatshme për sekretaren e ngarkuar që të mbajë procesverbalin, ngaqë ajo mund të shtypë direkt në kompjuter, të printojë dokumentin, t'ua dorëzojë atë palëve për një kontroll përfundimtar dhe po të lindë nevoja, të bëjë korigjimet e nevojshme menjëherë. Së dyti, vetë gjykatësit kursejnë kohën, ngaqë atyre nuk iu duhet të lëvizin në anën tjetër të ndërtesës. Së treti, zyra ofron një ambjent më të këndshëm, ngaqë është e ngrohur në dimër dhe e freskët në verë, ndërsa në sallat e gjyqit nuk ishte instaluar as sistem ngrohjeje, as ajër i kondicionuar apo

<sup>32</sup> Sipas nenit 6, pika 1 i Ligjit Nr. 9110 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda", Gjykata për Krime të Rënda si dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda gjykojnë me një trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, ndërsa në nenin 13, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me Gjykatat e Rretheve dhe Gjykatave Ushtarake thuhet se të dyja këto gjykojnë me një trup gjykues të përbërë nga tre gjykatës kur ka kryerje të veprës penale, dhe nga një gjyqtar kur ka kundravajtje penale. Neni 14 i Kodit të Procedurës Penale gjithashtu parashikon një trup gjykues prej tre gjyqtarësh për Gjykatën e Apelit (duke përfshirë dhe Gjykatën Ushtarake të Apelit).

<sup>33</sup> Për shkak të urgjencës të çështjes, ngaqë i pandehuri i mitur, dhe që supozohej të ekzaminohej nga një ekspert, ishte në një gjëndje të rëndë psikologjike. – Përmendet gjithashtu në pikën 2.b)

<sup>34</sup> Përkatesisht për 23 korrikun 2004 në orën 10.00.

dhe ventilatorë. Situata ka ndryshuar vetëm kohët e fundit për sallën e gjyqit në katin e parë, ngaqë ajo u pajis me ajër të kondicionuar menjëherë para fillimit të pushimeve të verës. Arsyeja e dhënë nga ana e gjyqtarëve për përdorimin e zyrave të tyre, përkatësisht që nuk ka salla gjyqi, duhet konsideruar si një justifikim, sepse vëzhguesit asnjëherë nuk vunë re që **të gjitha** sallat e gjyqit të ishin të zëna. Në fakt, në çdo kohë gjatë periudhës së vëzhgimit, në Gjykatën e Rrethit Tiranë, shumica e sallave të gjyqit nuk ishin në përdorim.

Pasoja e dukshme e zhvillimit të gjyqeve në zyrë është se numri i njerëzve që kanë mundësi ta ndjekin atë është i kufizuar. Hapësira që është në dispozicion vlen për një maksimum prej tre deri katër vëzhguesish. Prandaj, shkelet e drejta për një seancë publike.<sup>35</sup> Kjo e drejtë ka dy elementë përbërës: Gjykatat duhet të vënë në dispozicion informacionin në lidhje me kohën dhe vendin e zhvillimit të seancave verbale<sup>36</sup> dhe të krijojnë ambjente të përshtatshme, brenda kufijve të arsyeshëm, për ndjekjen seancave nga ana e pjesëmarrësve të interesuar të publikut. Kjo është “një masë sigurie për paanshmërinë dhe pavarësinë e procesit gjyqësor dhe një mjet për ruajtjen e besimit publik në sistemin e drejtësisë”.<sup>37</sup> Në mënyrë të dukshme gjatë procesit të vëzhgimit, politika në lidhje me vendin e zhvillimit të gjyqeve ndryshoi në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, veçanërisht pas fillimit të funksionimit të Gjykatës për Krime të Rënda. Gjykata për Krime të Rënda për shkak të numrit të madh të të pandehurve në paraburgim dhe duke pasur trupa gjykues më të mëdhenj në numër,<sup>38</sup> praktikisht ishte e detyruar të përdorte sallat e gjyqit. Ndoshta, kjo praktikë shërbeu si një shembull i mirë edhe për Gjykatën e Rrethit.

## 2. Aksesi për Informacion

### a) Gjyqet

#### aa) hyrje: kushtet e punës

Meqenëse raporti<sup>39</sup> mbulon Gjykatën e Rrethit Tiranë si dhe Gjykatën për Krime të Rënda, shqyrtimi i veprimtarive juridikionale të këtyre dy gjykatave përfshin një analizë krahasuese. Për këtë, mjediset e ndryshme të punës të të dy gjykatave u morën në konsideratë.

Gjykata e Rrethit Tiranë është e vetmja gjykatë në vend kryesisht e kompjuterizuar. Kjo u realizua në kuadër të projektit pilot “Automatizimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë”, zbatuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë- SOROS, në vitin 2000-2001. Projekti u zbatua në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, e cila drejtonte rindërtimin e ndërtesës së gjykatës. Gjatë zbatimit të projektit, çdo zyrë që kishte një gjyqtar dhe një sekretare të caktuar për të, u pajis me një kompjuter dhe një printer. Totalisht, u dhanë 50 kompjutera dhe 30 printera për mjediset e gjykatës si dhe gjeneratorë dhe bateri në mënyrë që të plotësoheshin ndërprerjet e energjisë. Nga një kompani vendase e teknologjisë së informacionit u krijua një program software dhe një faqe interneti specifikisht e përshtatur sipas nevojave të gjykatës.

<sup>35</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 10, CCPR, neni 14 (1), Konventa Europiane, neni 6 (1), Statuti i Jugosllavisë, neni 20 (4), Statuti i Ruandës, neni 19 (4), Statuti i ICC, neni 64 (7) dhe 67 (1). Për më tepër, e drejta e një seance publike në procesin penal gjithashtu përcaktohet në standartet ndërkombëtare; Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 11, Organi i Parimeve, P 36 (1), Konventa amerikane, neni 8 (5) dhe Deklarata amerikane, neni XXVI.

<sup>36</sup> Shih pikën 2.

<sup>37</sup> Fair Trial Manual, (Manuali për një Gjykim të Drejtë) Amnesty International, paragrafi B, kapitulli 14.

<sup>38</sup> Përkatësisht 5 në vend të 3 gjyqtarëve, neni 6, paragrafi 1 i Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda" dhe neni 13, paragrafi 2 i Kodit Penal.

<sup>39</sup> Për shkak të ndryshimeve në sistemin gjyqësor të përmendura në pikën B.1.

Projekti ishte i ndarë në dy faza. Në fazën e parë u krijua një rrjet dhe një sistem i brendshëm telefonik, u vunë në punë dy servera, ndërkohë që në fazën e dytë u prek administrimi i çështjeve. Çdo dosje që hyn, regjistrohet me një numër nga sistemi. Gjyqtarët më pas shpërndajnë mes tyre çështjet me anë të shortit. Përjashtime nga kjo ndarje e rastësishme bëhen lidhur me ngarkesën e punës. Më tej, u hap një faqe interneti për gjykatën. Faqja e internetit jep informacion në lidhje me gjyqet që do të zhvillohen, si p.sh. emrin e gjyqtarit përkatës ose kryetarit të trupit gjykues, emrin e të pandehurit, akuzën e ngritur, si dhe datën e orën e gjyqit. Sistemi është i azhornueshëm, që do të thotë se të gjitha vendimet ndërmjetëse të marra në çdo seancë si dhe vendimet gjyqësore mund të shtohen në sistem nga sekretarja. Përveç informacionit që jepet në internet, në korridorin hyrës së gjykatës janë vendosur tre kompjutera dhe – kohët e fundit – një ekran me prekje, në të cilin renditen gjyqet (civile dhe penale) e çdo gjyqtari për ditën përkatëse dhe atë pasuese. Tabelat përfshijnë të njëjtat çështjet që janë vendosur edhe në faqen e internetit. Përfundimisht të gjithë kompjuterat në zyrat e gjyqtarëve kanë akses në internet kështu që gjykatësit kanë një bibliotekë elektronike në dispozicion të tyre për qëllime kërkimi.

Ndryshe nga Gjykata e Rrethit të Tiranës, Gjykata për Krime të Rënda vuan nga një mungesë e burimeve njerëzore dhe materiale. Ky fakt ka një efekt dëmtes në administrimin e informacionit dhe pengon kështu mundësinë e ndjekjes së seancave nga publiku i interesuar.

Gjatë pjesës së parë të vitit të punës të Gjykatës për Krime të Rënda, para se Prezenca e OSBE-së të dhuronte 19 kompjutera dhe 3 printera në kuadrin e Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, gjykatës iu dhanë 5 kompjutera të vjetër nga Gjykata e Lartë. Asnjë nga këto kompjutera nuk kishte akses në internet, kështu që kancelari detyrohej të përdorte kompjuterin e tij personal jashtë orëve të punës me qëllim që të dërgonte postën elektronike një herë në javë tek përfaqësuesit e medias dhe vëzhguesit e OSBE-së. Ndonjëherë ai nuk mundte ta bënte këtë në kohë, kështu që vëzhguesve iu duhej të kontrollonin listën e gjyqeve që gjykata afishonte. Gjatë javëve të para të punës vëzhguesve iu desh të pyesnin personelin e gjykatës në lidhje me gjyqet e ardhshme. Më vonë, në mars 2004, programi javor u vendos në tabelën e afishimit të njoftimeve që ndodhej në hollin e katit të parë të Gjykatës së Rrethit Tiranë, i cili mbeti “i humbur” mes dokumenteve të ndryshme të tjera të vendosura atje. Në prill u vendos në murin e katit të katërt të Gjykatës së Tiranës një tabelë afishimi, aty ku ndodhet përkohësisht Gjykata për Krime të Rënda.

Përveç kësaj është varur dhe një tabelë me emrin e Gjykatës për Krime të Rënda, megjithëse në hyrjen kryesore të gjykatës nuk ka ndonjë referencë për Gjykatën për Krime të Rënda. Dyert e zyrave kanë tabela, por, ndërsa në tre katet e para të ndërtesës, të zëna nga Gjykata e Rrethit Tiranë, shkruhen emrat e gjyqtarëve, në katin e katërt, krejtësisht e caktuar për Gjykatën për Krime të Rënda, është shkruar vetëm funksioni (d.m.th. gjykatësit, sekretaret, zyra e financës). Zyra e kancelarit, që ndodhet në pjesën e ndërtesës që ka sallat e gjyqit, nuk ka tabelë të azhornuar, sepse më parë atje ka qenë një dhomë pritjeje për avokatët dhe prokurorët. Emrat dhe numrat e zyrave të gjyqtarëve që punojnë në Gjykatën e Rrethit Tiranë janë të vendosur në hyrjen e katit të dytë dhe të tretë.

*ab) Shërbimi*

Krahasuar me Gjykatën për Krime të Rënda, kushtet në Gjykatën e Rrethit Tiranë janë më të favorshme për garantimin e aksesit të informacionit për vëzhguesit, duke garantuar kështu të drejtën për një gjykim publik. Megjithatë dallimet nuk janë thelbësore për shkak të shumë rrethanave të ndryshme.

Para së gjithash, shpesh as faqja e internetit të Gjykatës së Tiranës, as ekranet në holl nuk janë të rifreskuara. Situata u përmirësua gjatë monitorimit.

Së dyti, vonesat dhe shtyrjet e seancave kërkojnë të kontaktosh me gjyqtarin që ka çështjen ose të paktën me sekretaren e tij. Meqenëse vonesat janë më tepër rregulli sesa përjashtimi,<sup>40</sup> për të marrë informacionin e duhur sido që të jetë duhet t'i drejtohesh gjykatësit ose sekretares së vet, dhe kështu disponueshmëria e një teknologjie të azhornuar luan rol më pak të rëndësishëm për shkak të shpeshësisë të ndryshimeve brenda planifikimit, të shkaktuara këto nga mungesa e palëve në proces, e dëshmitarëve, apo moshoqërimi i të pandehurve nën masën e sigurisë arrest me burg, kërkesa të paraqitura, etj. Për pasojë, marrja e informacionit aktual që lidhet me kohën dhe vendin e seancës që do të vëzhgohet, varet kryesisht nga kompetenca dhe dëshira e personelit të gjykatës.

Në përgjithësi, duhet thënë se në Gjykatën e Rrethit Tiranë, - me pak përjashtime -<sup>41</sup> veçanërisht gjykatësit ishin më të gatshëm dhe ndihmues për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me zhvillimin e seancave. Në Gjykatën për Krime të Rënda ka një konfuzion në lidhje me personin e duhur për t'u kontaktuar. Kancelari, i cili përgjigjet për përpilimin e programit javor, ka qenë shumë bashkëpunues qysh nga fillimi, por vetë ai nuk ishte informuar për zhvillimet më të reja lidhur me seancat më të fundit, meqenëse kjo nuk lidhet me detyrat e tij si shef i administratës. Ai u drejtohej nëpunësve gjyqësor, nëpunësit gjyqësor sekretareve dhe sekretaret gjyqarëve. Shumica e gjyqarëve nuk i dinin arsyet e vonesës dhe për pasojë nuk ishin në gjendje të përcaktonin nëse do të fillonte seanca tjetër dhe në ç'orë.

Këto dy shembuj ilustron boshllëqet lidhur me shkëmbimin e komunikimit ndërmjet stafit të gjykatës. Për pasojë, nuk jepet informacion i saktë për vëzhguesit, për të afërmit e miqtë e të pandehurve dhe viktimave apo edhe për përfaqësuesit e medias. Duket se arsyet për këto mangësi brenda administrimit të informacionit në gjykatë rezultojnë pjesërisht nga konfliktet e brendshme.

Meqenëse çështjet transferohen në Prokurorinë për Krime të Rënda – homologu i Gjykatës për Krime të Rënda – nga të gjithë prokuroritë e rretheve në të gjithë vendin, një numri të kosiderueshëm të të pandehurve në gjendje të lirë, avokatëve të mbrojtjes dhe dëshmitarëve, iu duhet të udhëtojnë në distanca të largëta. Për më tepër disa nga të pandehurit me paraburgim sillen nga policia nga burgje të tjera që nuk janë në Tiranë. Kushtet e rrugëve që janë edhe më të këqija në dimër, gjendja e trafikut dhe mungesa e personelit, mangësitë në transportim dhe pajisje (d.m.th. radiot e dorës, celularët) të policisë, të gjitha kontribuojnë për mbërritjen e të të pandehurve me vonesë. Në të kundërt, shumica e pjesëmarrësve në çështjet e gjykuara në Gjykatën e Rrethit Tiranë janë banorë të Tiranës dhe mund të kontaktohen lehtësisht me telefon në zyrat e tyre në mënyrë që t'u kërkohej sqarime për mbërritjen e tyre në gjykatë.

<sup>40</sup> Në nëntor dhe dhjetor 2003, 56 seanca gjyqësore nga 94 të tilla u shtynë, do të thotë më tepër se 50 %.

<sup>41</sup> Ja vlen të përmendim në këtë kontekst dy precedentë: një herë një gjyqtar iu dha vëzhguesve informacion të rremë në lidhje me vazhdimin e një procesi. Ai shpjegoi se seanca tjetër, në të cilën supozohej se do të dëshmonte një dëshmitar tjetër, do të zhvillohej në 20 nëntor. Në fakt seanca u mbajt para 20 nëntorit. Mbetet e paqartë, nëse kjo u bë me qëllim apo gabimisht, megjithëse në seancën e mëparshme të monitoruar, pjesëmarrësit në mënyrë të dukshme do të dëshironin që të përfundonte çështja pa dëshmitarin që mungonte, por nuk guxuan t'i shpërfillnin rregullat procedurale në prani të vëzhguesve. Në një çështje tjetër, gjykatësi, pas shpalljes së vendimit në një çështje, refuzoi të informonte ekipin e vëzhguesve për seancën tjetër, e cila fillimisht supozohej të zhvillohej më pas, duke pretenduar se ai kishte shumë ngarkesë pune dhe vëzhguesit nuk duhet ta shqetësojnë duke ardhur përsëri para vitit tjetër, sepse atëherë ai do të kishte "kohë për një kafe".



Përveç këtyre kushteve shumë të ndryshme, një faktor që e përkeqëson gjëndjen në Gjykatën për Krime të Rënda është mungesa e një pike të brendshme kontakti që të përgjigjet për mbledhjen e të gjithë informacionit që lidhet me planifikimin e seancave dhe që të azhurnojë personat e interesuar, pra, pjesëmarrësit në gjyq dhe vëzhguesit.

Përsa i përket informacionit për vendin ku do të zhvillohet gjyqi, është më e lehtë, sepse ka vetëm dy salla gjyqi të caktuara për Gjykatën për Krime të Rënda, përkatësisht salla e sigurisë së lartë në katin e parë të ndërtesës dhe një tjetër në katin e katërt. Meqenëse kjo e fundit është disi e vogël dhe nuk ka "kafazë" për të pandehurit, gjyqet me më shumë se një të pandehur me masë sigurimi arrest me burg zhvillohen në sallën e sigurisë së lartë.<sup>42</sup> Pavarësisht nga siguria relative e vendndodhjes, megjithatë është e komplikuar që të gjesh se cili gjyq do të kryhet më pas, për shkak të faktit se planifikimi është konceptuar në një mënyrë jopraktike. Meqenëse Gjykata për Krime të Rënda ka një ngarkesë të madhe pune dhe meqenëse pasditja nuk mund të përdoret për gjyqe për shkak të orëve të punës të policisë, gjyqet "ngjeshen" midis orës 08:30-09:00 dhe 13:00-14:00, kryesisht me një hapësirë prej gjashtëdhjetë ose nëntëdhjetë minutash midis tyre.

Zakonisht gjyqi i parë fillon me një vonesë të konsiderueshme,<sup>43</sup> që do të thotë se qysh nga fillimi nuk mund të respektohet lista e planifikuar, për më tepër që koha e caktuar për çdo seancë nuk është e mjaftueshme. Në rastet kur gjykata ka tetë çështje në vazhdim për të gjykuar me katër ose më tepër të pandehur që përfaqësohen nga një ose dy mbrojtës secili, marrja në pyetje e dëshmitarëve apo administrimi i provave zakonisht zgjat mjaft, duke patur parasysh faktin që çdo avokat ka të drejtën të bëjë pyetje, të bëjë komente, të depozitohet kërkesa, etj. Kjo është e vështirë për t'u administruar brenda një gjatësie kohore prej gjashtëdhjetë ose nëntëdhjetë minutash, kohë e cila në të shumtën e rasteve shkurtohet në sajë të vonesave të shkaktuara derisa të mblidhen pjesëmarrësit. Problemi i mbivendosjes me seancën pasuese<sup>44</sup> është "zgjidhur" nga gjykatësit, ose duke injoruar seancën tjetër të planifikuar, ose duke gjetur arsye për të shtyrë seancën, p.sh. në rastin kur depozitohen kërkesa nga njëra palë i jepet kohë palës tjetër që t'i komentojë ato ose i jepet kohë vetë trupit gjykues të marrë një vendim.

Më tej, meqenëse personeli i gjykatës nuk është i informuar për situatën më të fundit të transportimit të të pandehurve të mbajtur në dhomat e paraburgimit jashtë Tiranës, procedura që zbatohet është: të zhvillohen gjyqet sipas rradhës së ardhjes së të pandehurve. Prandaj kur vëzhguesit mbërrijnë në gjykatë për të ndjekur një çështje të caktuar, ka më shumë gjasa që salla e gjyqit të jetë bosh ose të jetë duke u zhvilluar një gjyq tjetër.

Pasojat e planifikimit jorealit nuk kushtëzojnë vetëm gjykatën. Për më tepër, avokatët mbrojtës të cilët kanë çështje të tjera gjyqësore, nuk janë në gjendje të marrin pjesë në to. Kjo shkakton shtyrje të seancës dhe prandaj ndikon në të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar pa

<sup>42</sup> Shih pikën 1.

<sup>43</sup> Mesatarja e vonesës së fillimit të seancave të zhvilluara në kuadrin e "çështjes Malushi" ishte 45 minuta. Nga 15 seanca vetëm dy filluan në kohë. Vonesa maksimale ishte dy orë e 50 minuta në rastin e seancës së parë, meqenëse arranzhimet për transportimin e të pandehurit Nikolin Prenga, të mbajtur në ambjentet e paraburgimit në Durrës, nuk siguruan mbërritjen e tij në kohë.

<sup>44</sup> Problemi i përplasjes ndodh vetëm për seancat e ndjekura me të pandehur të sjellë nga burgjet jashtë Tiranës. Në qoftë se bëhet fjalë për të pandehurit e Tiranës, e njëjta togë shoqërimi i kthen të pandehurit pas përfundimit të seancës në burg dhe merr të pandehurit e akuzuar të planifikuar për çështjen tjetër. Sigurisht kjo procedurë shkakton problemet e veta, ngaqë harxhon disi kohën.

vonesa të panevojshme.<sup>45</sup> Megjithatë bëhet fjalë jo vetëm për të pandehurit, por edhe për dëshmitarët. Atyre u duhet të presin për një kohë të gjatë në hyrjen e sallës së gjyqit bashkë me familjet dhe miqtë e të pandehurve, dhe për këtë arsye janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve.

Ka ndodhur që një seancë është përfunduar pa u dëgjuar dëshmitari dhe dëshmitarit i duhej të paraqitej një herë tjetër për të dhënë dëshminë e vet.

Më tutje, nevojat e personave të cënueshëm si të miturit, të moshuarit apo njerëzit me paaftësi fizike nuk janë marrë në konsideratë në planifikimin e gjykatës, duke konsideruar faktin se nuk ka një dhomë pritjeje të veçantë për dëshmitarët dhe nuk ka karrike të vendosura në hyrje të sallës së gjyqit në katin e parë. Më tej, dëshmitarëve iu duhet të përdorin të njëjtën hyrje dhe dalje me publikun, sepse tjetra është e rezervuar për personelin e gjykatës. Sigurisht këto praktika nuk i inkurajojnë dëshmitarët të dëshmojnë kundër kriminelëve në gjyq, duke patur parasysh se në Shqipëri nuk ka akoma një strukturë funksionale për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ligji për "Mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"<sup>46</sup> është miratuar nga Parlamenti dhe është dekretuar nga Presidenti, por aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit nuk janë hartuar deri tani. Kjo do të thotë që shumicës e dëshmitarëve u duhet të dëshmojnë hapur në gjyq me pasojën që emrat e tyre të citohen në gazeta dhe t'iu bëhen fotografi, sepse kufizime për median nuk ka.<sup>47</sup>

Duke patur parasysh vështirësitë që duhen përballuar, është e lehtë të merret me mend si mund të ndikohen njerëzit që nuk i njohin procedurat gjyqësore. Këta njerëz varen nga një sistem informacioni transparent të ofruar nga gjykata. Kjo do të thotë që i gjithë personeli i gjykatës, kryesisht nëpunësit gjyqësor, por edhe gjykatësit, sekretarët dhe stafi i administratës duhet të tregohet i ndjeshëm ndaj kërkesave të publikut, në veçanti për ata persona që kanë një bagazh të ulët arsimor, probleme mendore ose ata që janë emocionalisht të shqetësuar.

#### b) Vendimet gjyqësore

Proceset gjyqësore të çështjeve penale ose jo, duhet të bëhen publike<sup>48</sup> me përjashtime të pakta. Përjashtimet kanë të bëjnë me çështje ku përfshihen të miturit, jeta private e të cilëve duhet mbrojtur, mosmarrëveshjet martesore dhe çështjet për kujdestarinë e fëmijëve. Realiteti është pak ndryshe. Në fakt, kufizimet e aksesit për informacion nuk kanë të bëjnë thjesht me vetë gjyqin, por edhe me vendimet gjyqësore.

Në Gjykatën e Rrethit Tiranë, vendimet gjyqësore për secilën çështje të përfunduar supozohet që të publikohen në faqen e saj të internetit. Kjo faktikisht bëhet për pjesën më të madhe të proceseve, pavarësisht se ndonjëherë me vonesë të konsiderueshme. Megjithatë, vendimet e njërit prej gjyqtarëve, për çështjet e ndjekura nga vëzhguesit, nuk u publikuan në internet gjatë kohës së vëzhgimit të këtij projekti.

<sup>45</sup> Kjo e drejtë i detyron autoritetet që të sigurojnë se të gjithë proceset që nga faza para gjykimit deri në apelimin përfundimtar, të jenë të përfunduara dhe vendimet të jepen brenda një afati të arsyeshëm. Kjo është e përcaktuar në ICCPR, neni 14 (3) (c), Statuti i Jugosllavisë, neni 21 (4) (c), Statuti i Ruandës, neni 20 (4) (c) dhe Statuti i ICC, neni 67 (1) (c) sipas të cilave gjyqet për akuza penale duhet të zhvillohen pa shtyrje të panevojshme, dhe Karta Afrikane, neni 7 (1) (d), Konventa Amerikane, neni 8 (1), Konventa Europiane, neni 6 (1), të cilat kërkojnë që të gjitha gjykimet (d.m.th. penale dhe të tjera) të zhvillohen brenda një afati të arsyeshëm.

<sup>46</sup> Ligji Nr. 9205, datë 15 mars 2004.

<sup>47</sup> Shih gjithashtu pikën 8.

<sup>48</sup> ICCPR, neni 14 (1), Konventa Europiane, neni 6 (1), Statuti i Jugosllavisë, neni 23 (2), Statuti i Ruandës, neni 23 (2), Konventa Amerikane, neni 8 (5), Statuti i ICC neni 74 (5) dhe neni 76 (4).

Për vendimet e dhëna nga Gjykata për Krime të Rënda, nevoja e një kërkesë me shkrim u theksua nga kancelari. Për shkak të mungesës së udhëzimeve të detajuara, ishte e paqartë se kujt i duhej adresuar kërkesa, nëse ajo i duhej bërë vetëm një herë në përgjithësi apo individualisht për çdo çështje dhe nëse duhej bërë me gojë apo me shkrim. U ra dakort midis kancelarit dhe vëzhguesve që i duhej paraqitur atij një kërkesë e përgjithshme me shkrim dhe ai do të përgjigjej. Me të vërtetë vëzhguesit morën një përgjigje pozitive, por megjithatë ishin të nevojshme kërkesa të tjera gojore që lidheshin me gjyqe të ndryshme të vëzhguara. Për shkak të mosmarëveshjeve të brendshme, vëzhguesit morën vetëm gjashtë vendime në total para pushimeve të verës, megjithëse deri atëherë ishin përfunduar njëzet çështje. Si reagim i kërkesave të përsëritura u dërguan me postë elektronike dhjetë vendime të tjera.

Në lidhje me seancat në fazën para gjykimit (d.m.th. vendosja e masave të sigurimit), nuk zbatohet një politikë uniforme në të gjitha gjykatat e vendit. Ndonjëherë publikut i lejohet të marrë pjesë në seanca, ndonjëherë jo. E njëjta gjë aplikohet dhe për vënien në dispozicion të vendimeve gjyqësore lidhur me to.

Pavarësisht nga fakti se dispozita e Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimeve të rënda", që lidhet me gjykimet me dyer të mbyllura<sup>49</sup> është më e gjerë se ajo e Kodit të Procedurës Penale,<sup>50</sup> sepse ajo parashikon përjashtime shtesë "Kur një gjë e tillë çmohet e domosdoshme për çështjen që gjykohet ose për procedime të tjera, në interes të sigurimit kombëtar, rendit publik, të drejtësisë dhe të mbrojtjes së pjesëmarrësve në proces", deri tani vetëm një çështje vrasjeje është zhvilluar nga Gjykata për Krime të Rënda *in camera* (me dyer të mbyllura) me kërkesë të të pandehurit, një baba që vrau të birin.

### 3. Prania e pjesëmarrësve

Në kuadrin e 38 proceseve<sup>51</sup> të vëzhguara gjatë periudhës nga tetori 2003 deri në mars 2004 në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, nga 204 seanca, 73 u shtynë për shkak të mungesës së pjesëmarrësve. Kjo është më shumë se një e treta e seancave. Nga këto shtyrje, shumica, domethënë 28, ishin rezultat i mungesës së të pandehurit, 18 nga mungesa e prokurorit, 10 nga mungesa e dëshmitarëve të thirrur për të dëshmuar, 9 për mungesën e mbrojtjes, 7 nga mungesa e gjyqtarëve dhe 1 e shkaktuar nga mungesa e përfaqësuesit të ndihmësprokurorit. Brenda kategorisë së të pandehurve duhet bërë një dallim midis të pandehurve të gjykuar në gjëndje të lirë dhe atyre nën masën e sigurimit arrest me burg. Për rastet kur të pandehurit në paraburgim nuk ishin të pranishëm në gjykim, ata nuk u sollën nga toga e shoqërimit. Kjo ndodhi në 23 seanca, ndërsa në 5 seancat e tjera, të pandehurit gjykoheshin në gjëndje të lirë.

Në Gjykatën për Krime të Rënda nga shkurti 2004 deri në korrik 2004, nga vëzhguesit u ndoqën 138 seanca në kuadrin e 21 proceseve. Nga këto, 37 seanca në total u shtynë për shkak të mungesës së pjesëmarrësve në gjykim. Shumica prej këtyre 37 seancave nuk u zhvillua për shkak të mungesës së të pandehurve, avokatëve të mbrojtjes dhe dëshmitarëve. 15 seanca u shtynë sepse dëshmitari i thirrur për të dëshmuar nuk u paraqit, 11 për mungesën e avokatëve, 7 sepse mungonin të pandehurit, 3 sepse mungonte prokurori dhe 1 sepse kryetari – që vepronte si kryetari i seancës – po ndiqte një trajnim jashtë shtetit. Brenda grupit të të

<sup>49</sup> Neni 7, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 9110 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda" që lidhet me gjykimet me dyer të mbyllura.

<sup>50</sup> Neni 340 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>51</sup> Këto procese lidheshin kryesisht me krimet e rënda, si p.sh., krijimin e organizatave kriminale, vrasje, vrasje me paramendim, vjedhje me armë, trafikim lëndësh narkotike, duke përfshirë gjithashtu vepra të vogla penale si shpërdorim detyre dhe falsifikim i pasaportave.

pandehurve që mungonin, vetëm 3 seanca u desh të shtyeshin për shkak të moshoqërimit nga forcat e policisë. Në shumicën dërmuese të çështjeve, të pandehurit u sollën në seancë me vonesë të konsiderueshme.<sup>52</sup>

Përmirësimet në lidhje me praninë e pjesëmarrësve në Gjykatën për Krime të Rënda krahasuar me Gjykatën e Rrethit Tiranë janë mbresëlënëse, përkatësisht sepse kjo lidhet me vetë magjistratët dhe me transportimin e të pandehurve.

Në lidhje me magjistratët, duhet thënë se zakonisht në gjyqet e Gjykatës për Krime të Rënda marrin pjesë dy prokurorë, një prokuror rrethi që është fillimisht përgjegjës për hetimet dhe Prokurori i Krimeve të Rënda që merr çështjen.<sup>53</sup> Prandaj mundësia që të dy të mungojnë është më e vogël se sa në çështjet e gjykuara kur normalisht është i pranishëm vetëm një prokuror. Kështu, në pjesën më të madhe të seancave të kryera nga Gjykata për Krime të Rënda, të dy prokurorët ishin të pranishëm. Kjo mund të vlerësohet si një tregues i një disipline të mirë të punës, që vlen gjithashtu edhe për gjykatësit, meqënëse përveç rastit kur gjyqtari merrte pjesë në kursin e trajnimit jashtë shtetit, nuk u regjistrua asnjë shtyrje për mungesën e pjesëtarëve të trupit gjykues.

Lidhur me transportimin e të arrestuarve duket se gjykatësit e Gjykatës për Krime të Rënda janë më të motivuar për ta zhvilluar seancën se sa ata të Gjykatës së Rrethit Tiranë, duke i marrë parasysh edhe përplasjet që mund të shkaktohen me seancat e tjera të planifikuara. Por, situata mund të përkeqësohet sepse ndryshe nga Gjykata e Rrethit Tiranë, pjesëmarrësit në këto gjyqe vijnë nga i gjithë vendi dhe shtyrja e seancës, për shkak të mungesës së njëjës prej tyre, do të thotë që orë të tëra udhëtimi të pjesëmarrësve të tjerë do të shkonin dëm. Për më tepër, për shkak të ashpërsisë së krimeve, që gjykohen nga Gjykata për Krime të Rënda, në shumicën e rasteve për të pandehurit merren masa sigurimi dhe e drejta për tu gjykuar pa vonesa të panevojshme<sup>54</sup> është më e rëndësishme dhe detyrimi i shtetit për të përshpejtuar gjyqet për këdo që akuzohet për një vepër penale dhe mbahet në paraburgim është më i ngutshëm.<sup>55</sup>

Përfundimisht, sa më e gjatë të jetë koha midis kryerjes së kriminit dhe shpalljes së vendimit aq më e vështirë është të ketë prova të besueshme, për shembull, dëshmitarët mund të mos gjenden më, ose mund të kenë shkuar jashtë shtetit apo nuk e mbajnë mend ngjarjen, provat materiale mund të kenë humbur, etj. Nga ana tjetër, rritja e numrit të seancave të shtyra për shkak të mungesës së të pandehurve të gjykuar në gjendje të lirë shpjegohet me natyrën e centralizuar të Gjykatës për Krime të Rënda. Natyrisht është më e lehtë kur njoftohen persona, të cilët banojnë më afër gjykatës, meqënëse vendet dhe personat dhe adresat e tyre njihen nga stafi i gjykatës dhe nga oficerët e policisë gjyqësore dhe për këtë arsye, procedura e dorëzimit është më e thjeshtë dhe do më pak kohë.

Një tjetër problem është mungesa e një regjistri të plotë civil, të azhornuar dhe një sistemi adresash, që shpesh ndërlikon vërtetimin e mundësisë për t'u paraqitur, nga që barrën për këtë e

<sup>52</sup> Vonesa më e madhe ndodhi në seancën e hapjes së çështjes së parë të Gjykatës për Krime të Rënda, vrasja e shefit të komisaritit të Krujës Gani Malushi. Seanca filloi pothuajse 3 orë më vonë, sepse i pandehuri Nikolin Prenga nuk u soll nga dhomat e paraburgimit të Durrësit në kohë.

<sup>53</sup> Gjatë fazës përgatitore të ngritjes së institucionit të Prokurisë për Krime të Rënda me qendër në Tiranë, Prokurori i Përgjithshëm lëshoi urdhërin Nr.227, datë 19.12.2003. Sipas këtij urdhëri, prokuroritë e rretheve janë ngarkuar të hetojnë rastet e krimeve të rënda deri në vendosjen e masës së sigurisë dhe më pas dosja transferohet pranë Prokurorisë për Krime të Rënda për ta përfunduar çështjen.

<sup>54</sup> ICCPR, neni 14 (3) (c), Statuti i Jugosllavisë, neni 14 (3) (c), Statuti i Ruandës, neni 14 (3) (c), Statuti i ICC, neni 67 (1) (c), Karta Afrikane, neni 7 (1) (d), Konventa Amerikane, neni 8 (1), Konventa Evropiane, neni 6 (1).

<sup>55</sup> Manuali për një Gjykim të Drejtë, Amnesty International, paragrafi B, fq. 28.

ka gjykata. Në shumicën e gjyqeve me të pandehur në gjendje të lirë, akuzohen gjithashtu edhe të pandehur nën masën e sigurimit arrest me burg. Kjo vlen në veçanti për çështjet e trafikimit, në të cilat ata të pandehur që akuzohen për trafikim të qenieve njerëzore zakonisht janë të burgosur, ata që akuzohen si ndihmës gjykohen në gjendje të lirë dhe shpesh nuk paraqiten në gjykatë. Sipas nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale, një gjyq mund të zhvillohet në mungesë, por kjo prezumon njoftimin.

Gjykata përballet me një dilemë. Nga njëra anë, kuadri ligjor presupozon në parim praninë e të akuzuarit, dhe vetëm në raste të caktuara përjashtimore lejon një gjyq penal në mungesë<sup>56</sup> të të pandehurit. Por nga ana tjetër, duhet respektuar parimi i kohës së arsyeshme, qëllimi i të cilës është të mbrojtë të gjitha palët në procesin gjyqësor nga vonesat procedurale të tepërta.<sup>57</sup>

Në këtë situatë Gjykata për Krime të Rënda e trajton problemin ndryshe nga Gjykata e Rrethit Tiranë. Ndërsa Gjykata e Rrethit Tiranë realisht nuk i zbatoi standartet e vendosura nga legjislacioni vendas si dhe nga standartet ndërkombëtare për një gjykim të drejtë lidhur me gjykimet në mungesë,<sup>58</sup> Gjykata për Krime të Rënda është shumë e kujdesshme kur vjen puna e kontrollimit të supozimeve ligjore.<sup>59</sup> Kjo ka një rëndësi të veçantë lidhur me përjashtimet e tjera që përcaktohen me ligj për gjyqet e zhvilluara pa praninë e të akuzuarit, përkatësisht kur i akuzuari e kërkon këtë vetë ose jep pëlqimin që shqyrtimi gjyqësor të zhvillohet në mungesën e tij ose, kur është i arrestuar me burgim, refuzon të marrë pjesë, dhe kërkon të përfaqësohet nga avokati mbrojtës.<sup>60</sup> Ky rregull nuk parashikon përjashtime në lidhje me të miturit apo me njerëzit mendërisht të paqëndrueshëm. Në mënyrë që të caktohet një masë e duhur dënimi, është thelbësore përshtypja personale e trupit gjykues në lidhje me këto dy grupe (në rastin kur gjykata e deklaron të pandehurin përgjegjës dhe fajtor). Më tej, duhet të merret në konsideratë se persona të tillë mund të mos kenë pjekurinë e nevojshme për të llogaritur pasojat e mundshme të vendimit të tyre për të mos qenë të pranishëm në gjykatë.

Përfundimisht, vëzhgimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Tiranë zbuloi parregullsi në lidhje me përbërjen e trupit gjykues. Gjatë seancave të ndryshme të zhvilluara në kuadrin e të njëjtës çështjeje, ndodhi që nuk ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

<sup>56</sup> Neni 351 i Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë vendos që gjyqi mund të kryhet në mungesë kur i pandehuri nuk arrin të paraqitet përpara gjykatës pavarësisht se është i lajmëruar dhe nuk është vërtetuar pamundësia për t'u paraqitur. Kjo dispozitë është në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) dhe 6 (3) c- të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat kryesisht presupozojnë praninë e të akuzuarit, por në rrethana të caktuara përjashtimore, lejohet një gjykim në mungesë të tij/saj. Konkretisht neni 6 (1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut esencialisht thotë se çdo njeri ka të drejtën e një gjykimi të paanshëm e një seance me dyer të hapura brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme sipas ligjit. Neni 6 (3) c-e i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përshkruan të drejtën e përfaqësimit dhe ndihmës ligjore, të drejtën për pjesëmarrjen e dëshmitarëve dhe ekzaminimit si dhe të drejtën e një përkthyesi.

<sup>57</sup> Stoegmueller kundër Austrisë, 10 nëntor 1969

<sup>58</sup> për shembull, ne8 nga 15 gjykime të monitoruara, që u përfunduan në Gjykatën e Rrethit Tiranë gjatë fazës së parë të periudhës së vëzhgimit nga 29 tetori deri në 31 dhjetor 2003, të pandehurit u gjykuan në mungesë.

<sup>59</sup> Në rastin e përshkruar më parë deklarimi i avokatëve mbrojtës se i pandehuri që mungonte kishte autorizuar ata për ta përfaqësuar në gjyq në lidhje me konfirmimin nga ana e bashkëshortes së të pandehurit, e cila po ndiqte seancën, nuk u konsiderua fare nga gjykata.

<sup>60</sup> Neni 352 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në rastin e çështjes Vase Poitrimol kundër Francës, 23 nëntor 1993, se pala mund të mos e zbatojë të drejtën për të qenë e pranishme në një seancë gojore, por vetëm nëse refuzimi është i qartë dhe shoqërohet nga masa minimale sigurie në përputhje me rëndësinë e tij.

Kjo shkel të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë ligjërish kompetente si dhe shkel parimin e drejtpërdrejtshmërisë, meqënëse gjykatësit që mungojnë mund t'i bazojnë konstatimet e tyre në prova të paplota.

Incidente të tilla nuk u vunë re në Gjykatën për Krime të Rënda. Trupat gjykues, edhe kur përbëheshin ndryshe nga formacioni i tyre i zakonshëm, nuk u ndryshuan gjatë vazhdimit të procesit.

#### 4. Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore <sup>61</sup>

Shtyrjet e seancave janë arsyeja kryesore për zgjatjen e proceseve gjyqësore në Gjykatën për Krime të Rënda. Një nga arsyet kryesore është mungesa e palëve në proces. Një tjetër arsye lidhet me kërkesat që drejtohen nga organi i prokurorisë ose nga mbrojtja gjatë shqyrtimit gjyqësor, për të cilat gjykata duhet të marrë vendim. Kërkesat trajtohen me konsultime të menjëhershme të trupit gjykues, ose duke e shtyrë seancën, në varësi të llojit të kërkesës dhe të kohës që nevojitet për të marrë një vendim lidhur me të. Nga 138 seanca të vëzhguara në Gjykatën për Krime të Rënda, 11 u shtynë mbi bazën e kërkesave. Përkatësisht, dhjetë nga këto kërkesa u drejtuan nga mbrojtja. Nëntë prej tyre u ngritën gjatë gjykimit të çështjeve të trafikimit, një gjatë gjykimit të një çështje vrasjeje dhe një gjatë një çështjeje për vjedhje me armë. Tetë nga këto 11 kërkesa ishin kërkesa paraprake.

Fakti që shumica e kërkesave me shkrim depozitohen për çështjet e trafikimit, shoqëruar edhe me faktin që shumica dërrmuese e avokatëve mbrojtës nuk caktohen kryesisht, duket sikur tregon që, gjykimi i çështjeve të trafikimit është edhe një burim i mirë fitimi për një avokat, dhe kjo mund të shpjegonte synimin e tyre për të penguar përfundimin e gjykimit. Më tej, vihet re se kërkesat me shkrim paraqiten veçanërisht shpesh gjatë shqyrtimit të çështjeve komplekse, gjë që tregon se avokatët nuk kanë akses të plotë në dosje. Meqënëse këto dosje zakonisht janë shumë të mëdha, depozitimi i një kërkesë i jep avokatit kohë për të lexuar dosjet. Për më tepër, një numër avokatësh mbrojtës duket se e konsiderojnë hedhjen e kërkesave-“fishekzjarre” si një mjet të përshtatshëm për të impresionuar klientët e tyre, në mënyrë që të reklamojnë veten për tërheqjen e klientëve të tjerë.

Në anën tjetër, gjatë vëzhgimit të kryer në Gjykatën e Rrethit Tiranë, nga 204 seanca vetëm 3 u shtynë për shkak të kërkesave të paraqitura në gjykatë. Të tri mocionet u depozituan nga mbrojtja. Dy kishin të bënin me çështjet e trafikimit dhe njëra lidhur me një çështje për shpërdorim detyre. Të gjitha këto çështje ishin komplekse nga natyra dhe dosjet ishin disi voluminoze. Dy nga kërkesat u depozituan në fazën e parë të gjykimit, gjatë fazës së kërkesave paraprake, dhe pretendonin se mbrojtja nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për konsultimin e dosjes. Kërkesa e tretë synonte zëvendësimin e kryetarit të trupit gjykues duke pretenduar se ai ishte i njëanshëm. Kjo ishte e vetmja herë gjatë gjithë fazës së parë të programit që u vëzhgua se depozitohej një kërkesë e tillë. Kjo kërkesë u paraqit gjatë gjykimit të një çështjeje të bujshme që përfshinte akuzën e krijimit të organizatës kriminale, që merrej me trafikimin e drogës dhe kryerjen e veprimtarive në kuadrin e kësaj organizate. <sup>62</sup>

Numri shumë i madh i kërkesave që çon në shtyrjet e seancave të Gjykatës së Krimeve të Rënda krahasuar me Gjykatën e Rrethit Tiranë mund të shpjegohet me faktin se në Gjykatën për Krime të Rënda gjykohen krimet ose veprat penale me masë dënimi që fillon nga 15 vjet dhe kështu të pandehurit janë mjaft të rrezikuar. Për pasojë, avokati mbrojtës do të ndërmarrë

<sup>61</sup> Kjo pikë është e lidhur direkt me të mëparshmen; P.3. prania e pjesëmarrësve

<sup>62</sup> E ashtuquajtura "çështja Grori", meqënëse emri i të pandehurit kryesor është Arben Grori.

të gjitha veprimet e mundshme me qëllim që klienti i tij të deklarohet i pafajshëm ose të marrë një dënim më të butë. Një numër më i madh seancash u shty në Gjykatën e Rrethit Tiranë për shkak të mungesës së palëve, kështu avokatëve mbrojtës nuk iu duhej të përdornin kërkesa me shkrim për të patur kohë për studimin e përmbajtjes së dosjes.

Gjatë gjysmës së parë të vitit, Gjykata për Krime të Rënda përfundoi 20 çështje nga 81 të ardhura, d.m.th një të katërtën e çështjeve. Gjysma e tyre u zhvillua në kuadrin e gjykimit të shkurtuar.<sup>63</sup> Faktikisht ky numër rezultoi pak më i vogël se ai i gjykimeve të shkurtuara të zhvilluara në përgjithësi në të gjithë vendin, i cili gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004 arrin në 56%.<sup>64</sup> Gjykimi i shkurtuar presupozon që gjykata të vlerësojë se çështja mund të zgjidhet bazuar në përmbajtjen e dosjes.<sup>65</sup> Kjo do të thotë se provat e nevojshme janë numëruar në mënyrë të mjaftueshme nga organi i prokurorisë, dhe nuk është e nevojshme të dëgjohet asnjë dëshmitar në gjykatë, gjë që e shkurton procesin në mënyrë të konsiderueshme.

Që të dyja rastet e para të përfunduara në Gjykatën për Krime të Rënda ku akuza ishte vjedhje me armë u zhvilluan si gjykime të shkurtuara. Njëra çështje u përfundua me dy seanca gjyqësore, ndërkohë që tjetra me katër seanca. Kohëzgjatja mesatare për çështjet e tjera të përfunduara po nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda si gjykime të shkurtuara është prej gjashtë seancash. Duke marrë në konsideratë intervalin kohor prej 10 ditësh midis seancave të të njëjtës çështje, një çështje nën juridiksionin e Gjykatës së Krimeve të Rënda përfundohet në përgjithësi afërsisht brenda 2 muajsh. Çështja më e gjatë që është zhvilluar deri tani ka qenë "çështja Malushi" me 15 seanca. Seanca e hapjes ishte më 10 shkurt 2004 dhe shpallja e vendimit më 25 qershor 2004.

Gjendja në Gjykatën e Rrethit Tiranë është e ndryshme. Nga 38 çështje të vëzhguara, 22 u përfunduan, d.m.th më tepër se 50%. Kohëzgjatja mesatare e një çështje ka qenë 10 seanca. Çështja më e gjatë, e cila kishte filluar 6 muaj para se Prezenca<sup>66</sup> e OSBE-së të fillonte vëzhgimin e çështjeve penale në gjykata, ka qenë "çështja Grori" me 31 seanca. Seanca e parë filloi më 17 Prill 2003 dhe vendimi u shpall më 29 dhjetor 2003.

Duke patur parasysh faktin, që numri i seancave të shtyra, për shkak të mungesës së pjesëmarrësve, ishte shumë më i lartë në Gjykatën e Rrethit Tiranë, sesa në Gjykatën për Krime të Rënda, kohëzgjatja më e madhe e një gjyqi në Gjykatën e Rrethit Tiranë nuk të habit, megjithëse dallimi është i konsiderueshëm. Gjykatës së Rrethit Tiranë i duhet pothuajse dyfishi i kohës për të përfunduar një çështje në krahasim me Gjykatën për Krime të Rënda, megjithëse Gjykata për Krime të Rënda nis punën në mënyrë të konsiderueshme me disavantazh, dhe kjo sepse në rradhë të parë krimet e vogla - të cilat kanë më shumë gjase të trajtohen me shpejtësi - nuk janë nën juridiksionin e saj dhe ndërkohë pranë kësaj gjykate transferohen çështje nga i gjithë vendi, gjë që shpesh shkakton vonesa për shkak të vështirësive të organizimit të udhëtimit për personat e përfshirë në proces. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Tiranë shpesh përdor më shumë dispozitat e gjykimit të shkurtuar, duke shkurtuar kështu dëgjimin e provave dhe kjo është një tjetër arsye që kontribuon në shkurtimin e kohës së gjyqit.

Megjithatë, duhet të merret parasysh se, në sajë të informacionit të publikuar në internet nga Gjykata e Rrethit të Tiranës, u bë e mundur të përfshiheshin në llogaritje edhe seancat e

<sup>63</sup> Neni 403-406 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>64</sup> Prokuroria e Përgjithshme, "Informacion i treguesve kryesorë të punës së Prokurorisë, situata dhe përhapja e kriminalitetit gjatë 6 muajit të parë të vitit 2004", datë 30 korrik 2004, fq. 3

<sup>65</sup> Neni 404, paragrafi 1i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>66</sup> 17 prill 2003

mëparshme dhe se këto lloj çështjesh që janë përfunduar nga Gjykata për Krime të Rënda janë më pak komplekse nga natyra.<sup>67</sup>

## 5. Sjellja profesionale e palëve në gjykim

### a) Gjykatësit

Zhvillimi i procesit gjyqësor varet në një masë të madhe nga personaliteti i gjyqtarit që kryeson trupin gjykues. Kjo vlen si për Gjykatën e Rrethit Tiranë, ashtu dhe për Gjykatën për Krime të Rënda. Në rastin e vëzhgimeve të kryera në Gjykatën për Krime të Rënda, sidoqoftë mund të vihej re një trajtim më i orientuar drejt punës në ekip. Gjatë gjykimit, gjyqtarët konsultoheshin me njëri tjetrin shumë herë, p.sh. në rastin e kërkesave të depozituara nga palët, paraqitjes së kërkesave paraprake apo për të fiksuar datën e seancës në vazhdim.

Për më tepër, ka një shpërndarje të detyrave brenda trupit gjykues, ku një ose dy nga anëtarët e trupit gjykues veprojnë si *rapporteurs*, d.m.th. ata marrin shënime në lidhje me deklaratimet e dhëna nga ana e të pandehurve ose dëshmitarëve. Disa nga pjesëtarët e trupit gjykues përfshihen në pyetjen e këtyre dy grupeve, më aktivisht përfshihet kryetari i seancës, pasuar nga *rapporteurs*.

Në anën tjetër, në Gjykatën e Rrethit Tiranë, gjykatësit rrallë marrin shënime dhe duket sikur mbështeten kryesisht tek procesverbali i mbajtur nga sekretarja. Veç kësaj, pjesëtarët e tjerë të trupit gjykues, përveç kryetarit, zakonisht mbeten të heshtur gjatë pyetjes së dëshmitarëve. Për pasojë, informacionet e vlefshme apo gabimet procedurale mund të mos vihen re. Mundësia e gabimeve reduktohet shumë, kur të gjithë pjesëtarët e trupit gjykues kanë mundësi të mjaftueshme të marrin pjesë. Kjo u jep atyre një ndjenjë përgjegjësie, e cila e bën një proces gjyqësor më të efektshëm. Përveç kësaj, aftësitë e secilit prej pjesëtarëve të trupit gjykues mund të kontribuojnë për një përfundim “të suksesshëm” të gjykimit.

Megjithatë, puna në ekip në Gjykatën për Krime të Rënda nuk e zëvendëson punën e çdo gjyqtari, që vjen nga personaliteti i tij, arsimimi, përvoja etj. Për shembull, një gjyqtare krijon përshtypjen e të qenit arrogante, kur ajo vepron si kryetare e trupit gjykues, ç’ka i bën dëshmitarët të ndjehen të frikësuar.

Veç këtyre, vëzhguesit kanë vënë re brenda periudhës së vëzhgimit se ekzistojnë lidhje të afërta midis gjyqtarëve të Krimeve të Rënda, të cilët nuk e njihnin njëri-tjetrin në fillim, meqenëse ata të gjithë vinin nga rrethe të ndryshme nga i gjithë vendi. Efektet e plota të këtyre lidhjeve të ngushta nuk mund të gjykohen akoma, por rezultatet negative janë të parashikueshme. Kjo mund të shikohet në rastin e dy gjyqtarëve të caktuar në të njëjtin trup gjykues.<sup>68</sup> Këta gjyqtarë kanë krijuar lidhje të ngushta miqësie, zakonisht ata ulen pranë njëri-tjetrit gjatë gjyqeve dhe shpesh bëjnë biseda, që nuk lidhen me punën. Kjo është parë me mosmiratim nga ana e një kolegu tjetër, i cili është pjesë e të njëjtit trup gjykues. Ky person ka

<sup>67</sup> Kjo ilustron me çështjet e reja në gjykim nga Gjykata për Krime të Rënda në pranverë të 2004. Në dy çështjet e gjykuara, njëra u përfundua në muajin shkurt. Në muajin mars nga 25 çështje, 4 dhe asnjë nga 9 çështjet e gjykuara në prill. Për çështjet në vazhdim në mars, u ruajt shuma mesatare prej 10 seancash, për muajin prill 7 seanca për çështje.

<sup>68</sup> Aktualisht, në Gjykatën për Krime të Rënda punojnë 11 gjykatës (përfshi dhe kryetarin). Sipas përbërjes organike, 16 gjykatës (përfshi kryetarin dhe zëvendësin) ishin parashikuar të caktoheshin në këtë gjykatë. Thuhet se për shkak të numrit të reduktuar të çështjeve në krahasim me llogaritjen e Ministrisë së Drejtësisë për 400 çështje në vit (pas 6 muaj e gjysëm pune, në gjykatë kanë mbërritur 81 dosje), nuk janë emëruar gjykatës të tjerë për gjykatën deri tani, por thuhet se planifikohet një zgjerim në të ardhmen e afërt, shih pikën H.



treguar një nivel të lartë profesionalizmi, shoqëruar me një angazhim të madh në punën e tij. Më tej, dallime të konsiderueshme mund të vihen re në mënyrën sesi drejtohen proceset gjyqësore nga të dy trupat gjykues. Ndërsa një trup gjykues<sup>69</sup> duket se është i motivuar dhe punon me mjaft kujdes për çdo çështje, pjesëtarët e trupit tjetër gjykues shpesh duken të lodhur, përtypin çimçakiza dhe iu hapet goja gjatë procesit. Në përgjithësi, këta të fundit janë më të gatshëm për të shtyrë seancën dhe koha që i kushtohet pyetjes së dëshmitarëve është shumë më e shkurtër.

#### b) Prokurorët

Prokurorët në përgjithësi janë pasivë, gjë që detyron trupin gjykues të marrë një rol shumë më aktiv në pyetjen e dëshmitarëve sesa në fakt parashikohet në Kodin e Procedurës Penale.<sup>70</sup> Në mënyrë më specifike, gjatë gjykimit të dy çështjeve të bujshme, kryetarit të trupit gjykues iu desh të refuzonte shumë nga pyetjet e bëra nga prokurorët meqënëse ishin pyetje sugjestive.

Në një nga çështjet e bujshme, "çështja Malushi", kjo dobësi e Prokurorit të Krimeve të Rënda - që u theksua në konkluzionet përfundimtare të mbrojtjes - u kompensua nga Prokurori i Rrethit i caktuar për çështjen, i cili tregoi aftësi më të mira në mbledhjen e informacionit nga dëshmitarët dhe të pandehurit. Në një çështje tjetër "Banda Petalli",<sup>71</sup> ishte prokurorja e rrethit ajo që nuk pati sukses me pyetjet e saj. Ndryshe nga kolegu i Prokurorisë për Krime të Rënda, që përmendëm më parë, i cili nuk ndihej i frenuar në vazhdimin e linjës së pyetjeve të tij, ajo u dorëzua, megjithëse dëshmitari i thirrur për të dëshmuar kishte një rëndësi të madhe në lidhje me vërtetimin e provave, meqënëse ai i kishte kërkuar njërit prej të pandehurve që të mundësonte një nga fëmijët e të afërmëve të tij të trafikohej në Itali me dokumente të falsifikuara. Prokurori i Krimeve të Rënda, që kishte çështjen, nuk dha asnjë kontribut në marrjen në pyetje.

Në të dy çështjet e përshkruara më lart, prokurorët, që bënë pyetjet, nuk kishin ndjekur Shkollën e Magjistraturës, dhe kjo mund të mbështeste teorinë e Kryetarit të Gjykatës, i cili ia atribuonte sistemit "të vjetër" arsimor mangësitë e prokurorëve për pyetjet e bëra dëshmitarit, meqënëse ata nuk kishin ndjekur Shkollën e Magjistraturës. Tani kjo shkollë është e detyrueshme për prokurorët dhe për gjyqtarët. Programi mësimor atje përfshin ushtrime të lidhura me etapat e gjyqit, për shembull, marrjen në pyetje të të akuzuarit dhe dëshmitarëve, kërkesat dhe paraqitjen e konkluzioneve. Ndërkohë, kryeprokurori i Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pasi u vu në dijeni për problemin, ka ndërmarrë disa përpjekje për ta trajtuar këtë shqetësim, duke qënë se ai ka përkrahur shkëmbimin e informacionit mes vartësve të tij si dhe zbatimin e ushtrimeve për paraqitjet verbale në gjykatë. Ky trajtim duhet mirëpritur, sepse prokurorët që s'kanë trajnimin e Shkollës së Magjistraturës kanë rastin të përfitojnë nga kolegët e tyre.

Ndryshe nga paraqitja e prokurorëve në Gjykatën për Krime të Rënda, të cilët megjithë disa mangësi ishin të përgatitur mirë në përgjithësi, prokurorët në Gjykatën e Rrethit Tiranë me sa duket nuk kanë harxhuar shumë kohë për të përgatitur çështjet e tyre. Zakonisht, ata nuk kishin

<sup>69</sup> Të cilit i përket gjyqtarit të lartpërmendur

<sup>70</sup> Sipas nenit 361 të Kodit të Procedurës Penale pyetja e dëshmitarëve bëhet direkt nga prokurori ose nga avokati mbrojtës që ka kërkuar marrjen në pyetje. Pas kësaj pyetjeje e vazhdojnë me radhë palët. Vetëm në lidhje me pyetjen e dëshmitarëve të mitur, neni 361, paragrafi 5 deklaron se kjo mund të kryhet nga kryetari, me kërkesën dhe kundërshtimin e palëve. Për ndryshe, kryetari mund të bëjë pyetjen dhe, kur është rasti, ndërhyr për të siguruar radhën e pyetjeve, vërtetësinë e përgjigjeve, saktësinë e pyetjeve dhe të kundërshtimeve, si dhe për të garantuar respektimin e personit (neni 361, paragrafi 6)

<sup>71</sup> Të pandehurit dyshohen se janë të përfshirë në aktivitete kriminale të bandës italiane Petalli lidhur me trafikimin e fëmijëve.

as dosje as kode me vete dhe ia linin pjesën më të madhe të pyetjeve për të pandehurit dhe dëshmitarët kryetarit të trupit gjykues.

Ndërsa në Gjykatën për Krime të Rënda, prokurorët vetëm dy herë shkaktuan vonesa për shkak të problemeve organizative, kolegët e tyre në Gjykatën e Rrethit Tiranë vinin shpesh me vonesë dhe ndonjëherë as shqetësoheshin për të bërë justifikimin e vonesës së tyre. Një prokuror përmendi në një rast fjalët "shumë punë".

Ndryshe nga ai i vendeve të tjera,<sup>72</sup> Kodi shqiptar i Procedurës Penale nuk parashikon përdorimin e sanksioneve për të gjitha palët e një procesi gjyqësor, me qëllim krijimin e lehtësirave për përfundimin e çështjes,<sup>73</sup> megjithëse një forcë e tillë do të reduktonte shtyrjet e seancave në mënyrë më efektive në krahasim me kufizimet që mund të vinin nga marrja e masave disiplinore të lëna pak a shumë në gjykimin e Prokurorit të Përgjithshëm apo Dhomës së Avokatisë, të cilët mund të mos kenë interes të tregohen shumë të ashpër në këtë drejtim.

#### c) Avokati Mbrojtës

Në përgjithësi avokatët mbrojtës ishin njohur mjaft mirë me dosjet dhe ishin mjaft aktiv në depozitimin e kërkesave drejtuar gjykatës, dhe në veçanti, lidhur me kundërshtimet për pranimin e provave të sugjeruara nga organi i prokurorisë. Në mënyrë të veçantë kjo u vu re gjatë gjykimit të çështjeve penale të filluara në Itali dhe më pas transferuar tek autoritet shqiptarë. Ndryshe nga këto çështje të bujshme, për të cilat media tregon një interes të madh dhe për pasojë emri i avokatit bëhet më i njohur në publik, avokatët e caktuar kryesisht bënin dukshëm më pak përpjekje. Kjo u vu re si në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ashtu dhe në Gjykatën për Krime të Rënda.

### **6. Siguria dhe rendi publik**

#### a) Mjediset

Aktualisht si Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata për Krime të Rënda ndodhen në të njëjtën ndërtesë. Ndërtesa është e ndarë në tri pjesë, një pjesë me sallat e gjyqit, një pjesë me zyrat e personelit, dhe një pjesë e tretë që është e zënë nga KESH-i, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare. Kjo pjesë ka një hyrje të veçantë nga hyrja për në gjykatë. Kalimet e mëparshme nga KESH-i në Gjykatë janë ndarë me mur nga kati i parë në katin e tretë. Vetëm në katin e katërt, ndodhet një ndarje me hekura, me një derë. Kjo ndarje është bërë sepse në pjesën e gjykatës ndodhet një zyre që përdoret nga KESH-i.

Secila nga pjesët e ndërtesës në përdorim të gjykatave ka hyrje të veçantë (hyrje për në sallat e gjyqit dhe hyrje për në zyrat e personelit), por ekziston gjithashtu mundësia për të kaluar direkt nga pjesa ku gjenden sallat e gjyqit, tek ajo pjesë ku ndodhen zyrat. Vetëm personeli i gjykatës lejohet ta përdorë këtë hyrje, pavarësisht se aktualisht nuk bëhen kontrole. Nuk ka kontroll në hyrje për këto dy pjesë të ndërtesës,<sup>74</sup> që do të thotë se pothuajse çdo njeri mund të futet në çdo

<sup>72</sup> Për shembull, në Bosnjë-Hercegovinë, Neni 43 RS/25 FBiH Kodi i Procedurës Penale parashikon sanksione në rastin kur prokurori ose zëvendësi i tij nuk paraqiten në gjyqin kryesor. E njëjta gjë vlen edhe për të akuzuarin (Neni 253 RS/261 FBiH), avokatin (Neni 256 RS/263 FBiH) dhe dëshmitarët apo dhe ekspertët (Neni 256 RS/264 FBiH).

<sup>73</sup> Neni 351 i Kodit të Procedurës Penale i jep të drejtë gjykatës të deklarojë mungesën e të pandehurit dhe për pasojë të procedojë pa të në rrethana të caktuara. Një mundësi tjetër është shoqërimi i detyrueshëm i të pandehurit, neni 353 i Kodit të Procedurës Penale. Më tej, neni 364 i Kodit të Procedurës Penale ofron mundësinë për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe ekspertët në shtëpitë e tyre.

<sup>74</sup> Gjatë pushimeve të verës, u instalua një detektor metalik në hyrje të ndërtesës ku ndodhen sallat e gjyqit.

zyrë pa u kontrolluar për armëmbajtje. Vetëm në katin e katërt të ndërtesës, ku aktualisht ka nëntë zyra<sup>75</sup> të zëna nga Gjykata për Krime të Rënda, një roje ruan zyrën e kryetarit të Gjykatës për Krime të Rënda. Në qoftë se dikush do t'i bëjë një vizitë kryetarit, ai duhet të presë deri sa roja të ketë marrë miratimin e kryetarit. Pavarësisht nga ky fakt, do të ishte shumë e lehtë hyrja në zyrën e kryetarit forcërisht, meqenëse roja nuk e ka mendjen ndërkohë që u përgjigjet kërkesave të publikut, zhvillon biseda me personelin e gjykatës ose nëse nuk është në detyrë për shkak të detyrave të tjera.

Dosjet, materialet e sekuestruara dhe të konfiskuara ruhen në zyra të pambyllura, duke qënë se Gjykata për Krime të Rënda ka pak kasaforta (funktionale) në dispozicion. Për pasojë, provat materiale janë të ekspozuara ndaj vjedhjes, zjarrit etj. Rreziku i vjedhjes së materialeve të depozituara në zyra përkeqësohet nga fakti që në katin e katërt të gjykatës ndodhet zyra e lartpërmendur e KESH-it, që rrit numrin e vizitorëve. Për më tepër, dyert e zyrave të sekretarive janë zakonisht të hapura, meqenëse aty janë vendosur faksi dhe fotokopja ndërkohë që gjyqtarët, kancelari dhe nëpunësit gjyqësor hyjnë dhe dalin shpesh nga dhoma për të përdorur pajisjet e zyrës. Duke qënë kjo situatë, praktika e zhvillimit të gjyqeve në zyrat e gjyqtarëve është një shqetësim për sigurinë. Fatmirësisht, në lidhje me Gjykatën për Krime të Rënda, kjo ka ndodhur vetëm një herë,<sup>76</sup> por në Gjykatën e Rrethit Tiranë ky ka qënë më shumë rregull se sa përjashtimi, veçanërisht në periudhën e parë të vëzhguar nga tetori 2003 deri në dhjetor 2003.

#### b) Kontrollet për sigurinë

Kur një gjyq zhvillohet në një nga sallat e gjykatës dhe kur të pandehurit janë nën masën e sigurisë arrest me burg, vëzhguesit dhe çantat e tyre kontrollohen për armë nga policët para se ata të lejohen të hyjnë në sallën e gjyqit. Në këtë kontekst duhet përmendur se kontrollet nuk bëhen tërësore.

Për shembull, policia i kërkon publikut të mbyllë celularët, por rrallë bëhet verifikimi. Shumica e gazetarëve që ndjekin seancën ose nuk e marrin parasysh këtë kërkesë, ose pasi kanë zënë vend në sallën e gjyqit, i ndezin përsëri celularët. Në raste të shumta vëzhguesit vunë re se u bënë telefonata ose iu përgjigjën telefonatave gjatë zhvillimit të gjyqit, pa u vënë re nga policia ose pa u marrë parasysh kërkesat e policisë për të fikur telefonat.

Shkalla e vëmendjes që policia i kushton publikut në përgjithësi, duke përfshirë edhe nivelin e kontroleve të plota, në përgjithësi varet nga personeli i policisë në shërbim. Prandaj standartet e sigurisë aplikohen arbitrarisht dhe pa një strategji të saktë. Për shembull, ndonjëherë vëzhguesve u kërkohet t'i lënë çantat në rradhën e fundit të vendeve në sallën e gjyqit, ndërkohë që ndonjëherë atyre u lejohet t'i marrin ato me vete.

Deri tani nuk mund të vihet re një lidhje midis shkallës së kontroleve të sigurisë dhe natyrës së procesit gjyqësor.<sup>77</sup> Veprimet arbitrare të policisë favorizohen nga mungesa e një rregulloreje të brendshme për Gjykatën për Krime të Rënda. Ministrisë së Drejtësisë ka kompetencë të hartojë një rregullore të tillë të brendshme, por deri tani nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim.<sup>78</sup> Për pasojë përplasjet e policisë me pjesëmarrësit gjatë procesit janë të pashmangshme. Arsyeja për

<sup>75</sup> Pas emërimit të pesë gjyqtarëve të tjerë do t'i kërkohen dhe dy zyra të tjera Gjykatës së Rrethit Tiranë nga Gjykata për Krime të Rënda (shih gjithashtu pikën H).

<sup>76</sup> Shih pikën 2. a.

<sup>77</sup> Për shembull një çështje e bujshme për të cilën merren masa sigurie më të ashpra për publikun.

<sup>78</sup> Për shkak, siç thuhet, të mungesës së kohës dhe burimeve njerëzore si dhe detyrave të tjera të një rëndësie parësore, p.sh. finalizimi i të ashtuquajturës paketa ligjore Anti-Mafia.

këtë mund të jetë se personeli i policisë shpesh e konsideron mbrojtjen si një pikë më të dobët në krahasim me prokurorinë dhe gjykatën dhe kështu ndihen më të inkurajuar për të përdorur fuqinë e tyre ndaj pjesëmarrësve në gjyq që kanë lidhje me mbrojtjen.

Këto lloj debatesh të zhvilluara në praninë e përfaqësuesve të medias dhe pjesëtarëve të familjes nuk e përmirësojnë imazhin e Gjykatës së Krimeve të Rënda si institucion. Kryetari ose gjykohet të jetë tepër i dobët për zbatimin e vendimit të tij ose shikohet tepër i butë për zbatimin e standardeve të sigurisë. Nga të dyja këndvështrimet, komunikimi midis stafit të gjykatës, veçanërisht gjyqtarëve dhe policisë lë shumë për të dëshiruar. Për të bërë përmirësime në këtë drejtim, duhen planifikuar mbledhje të rregullta për të sqaruar fushat e përgjegjësisë të secilit, duke diskutuar çështjet shqetësuese dhe duke paraqitur sugjerime. Siguria mund të arrihet vetëm me një bashkëpunim të të gjitha palëve të përfshira.

Masa duhen marrë edhe për të siguruar më shumë transparencë lidhur me masat e sigurisë për publikun. Prania e policisë përqëndrohet në sallën e gjyqit. Kështu përplasjet midis anëtarëve të familjes së të pandehurit dhe atyre të viktimës, që mund të kthehen në raprezalje ndaj dëshmitarëve,<sup>79</sup> si dhe sjellja jo e mirë e përfaqësuesve të medias nuk vihen re gjithmonë nga policia. Zakonisht, pasi ka filluar seanca, jashtë sallës së gjyqit para derës qëndron vetëm një polic, i cili kontrollon hyrjen e të vonuarve. Fushëpamja e hyrjes në ndërtesë, si dhe veçanërisht ajo para ndërtesës është e kufizuar. Për më tepër policit, që qëndron jashtë sallës së gjyqit, herë pas here i duhet të lerë vendin e tij në mënyrë që të konsultohet me kolegët në sallën e gjyqit. Ky është një shqetësim i veçantë, sepse nuk ka dhomë pritjeje apo një hyrje të veçantë, që mund ta përdorin dëshmitarët.

Nëpunësit gjyqësor nuk kanë bërë ndonjë trajnim të veçantë për teknikën e mbrojtjes, me qëllim që të jenë në gjendje të ndërmarin veprime kundrejt sulmeve fizike. Kjo do të ishte veçanërisht e rëndësishme, meqenëse në gjyqet me të pandehur në gjendje të lirë<sup>80</sup> ose të pandehurit e gjykuar në mungesë, detyra e ruajtjes së rendit publik kryhet nga nëpunësit gjyqësor.

Një pikë tjetër shqetësuese, që lidhet ngushtë me problemin e veprimit të policisë në mënyrë mjaft arbitrare gjatë zbatimit të standardeve të sigurisë, është mosndjekja e këtyre udhëzimeve nga ana e përfaqësuesve të medias. Edhe kur atyre u kërkohet që të mos uleshin në rradhën e parë sa më afër hekurave me të pandehurit dhe të mos regjistrojnë me kamera gjatë seancës, ata prireshin të mos i merrnin parasysh këto urdhra të policisë duke qenë të vetëdijshëm për faktin se polici nuk do të vazhdonte më tej, domethënë, se nuk do t'i lëvizte ata ose nuk do t'u merrte pajisjet me forcë.

Nevoja urgjente për veprim në fushën e sigurisë i përket në mënyrë të veçantë Gjykatës së Krimeve të Rënda, meqenëse shumë nga çështjet e gjykuara nga kjo gjykatë tërheqin vëmendjen e publikut për shkak të natyrës së tyre sensacionale dhe prandaj kanë një interes të madh për median. Por kjo vlen edhe për çështjet e bujshme të mbetura nën juridiksionin e

<sup>79</sup> Shih gjithashtu pikën 7.

<sup>80</sup> Duhet shënuar se çështjet me të akuzuar, që nuk janë të burgosur, rrallë gjykohen në Gjykatën për Krime të Rënda meqenëse kompetenca e gjykatës kryesisht përfshin krimet me një gamë ndëshkimi jo më pak se 15 vjet. Kështu zakonisht të pandehurit në gjendje të lirë akuzohen bashkë me bashkëpunëtorët, që janë nën masën e sigurisë arrest me burg.

gjykatave të rretheve, për shembull si "çështja Karaburuni",<sup>81</sup> që është duke u gjykuar aktualisht në Gjykatën e Rrethit Vlorë.

Natyrisht, për këto çështje të ndjeshme, lajmet e publikuara nga media duke zbuluar emrat e dëshmitarëve, duke marrë fotografitë e tyre dhe duke cituar deklaratat e tyre rrisin shumë rrezikun e raprezaljeve. Kjo vlen edhe për policët në shërbim, që filmohen kur janë duke ruajtur të pandehurit. Për më tepër publikimi i deklaratave të regjistruara me kamera që shfaqin dëshmitarët ose të pandehurit rrezikon suksesin e përpjekjeve të gjykatës për vendosjen e drejtësisë, sepse dëshmitë pasardhëse mund t'i përshtaten informacionit të cituar tashmë nga media. Duhet theksuar se informacioni i bazuar në shënimet e marra nga gazetarët dhe më pas botuar në media rrallë përputhet me faktet reale, ngaqë shumica e tyre ose nuk e dëgjojnë me vëmendje gjyqin ose nuk e ndjekin atë dhe shpesh thjesht mbështeten tek përmbledhja gojore, që iu japin kolegët e tyre.

Pavarësisht nga kjo situatë shqetësuese, institucioni i ri i Gjykatës për Krime të Rënda duket se është disi pasiv në lidhje me median, ndoshta mund të ketë frikë nga krijimi i një imazhi të keq për gjykatën.

## 7. Dëshmitarët

Duke patur parasysh organizimet e pamjaftueshme në gjykatë për të garantuar sigurinë personale të dëshmitarëve, mosrespektimin e jetës private apo mbrojtjes së të dhënave nga ana e medias, si dhe faktin që zbatimi i Ligjit "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"<sup>82</sup> do kohë, veçanërisht për shkak të akteve nënligjore teknike që duhet të hartohen, mund të thuhet që për momentin mbrojtja e dëshmitarit në Shqipëri ndodh vetëm si rast i veçantë. E vetmja masë që u zbatua në dy raste të gjykuara nga Gjykata për Krime të Rënda, e cila ishte bazuar në një kërkesë të mëparshme të Prokurorisë për Krime të Rënda, ka qenë shoqërimi i dy dëshmitarëve nga oficerë të policisë gjyqësore kur dëshmuar para gjykatës.

Përveç rrezikut të rregjistrimit të dëshmitarëve dhe përhapjes së tyre nëpërmjet medias së shkruar, përpara se të gjitha provat të administrohen nga gjykata, dhe duke qenë se këto publikime rrisin mundësinë e ndikimit tek dëshmitë pasuese, ekziston rreziku që gjykata të mos kontrollojë nëse dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar kanë qenë të pranishëm në sallën e gjyqit përpara se të pyeten.

Para së gjithash, gjykata nuk pyet gjithmonë që në fillim të seancës nëse ka dëshmitarë midis vëzhguesve. Së dyti, nuk bëhen kontrole nëse njerëzit rrinë të heshtur, megjithëse janë thirrur të dëshmojnë. Kjo ka ndodhur disa herë gjatë vëzhgimit të kryer në Gjykatën për Krime të Rënda. Identifikimi i dëshmitarëve në parim varet nga prokuroria dhe mbrojtja dhe sa ata e njohin çështjen. Varet nga kujtesa dhe vëmendja e tyre me qëllim që gjykata të ketë mundësinë që t'u kërkojë këtyre dëshmitarëve të mos jenë prezent në sallën e gjyqit deri sa të japin dëshminë. Në qoftë se dëshmitarët identifikohen tepër vonë dhe nëse nuk është vënë re deri atëherë se një dëshmitar ka marrë pjesë në seancë dhe ka dëgjuar dëshminë e të pandehurve apo dhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, dëshmia e tij për pasojë hidhet poshtë si mjet prove – duke dëmtuar seriozisht gjykimin.

<sup>81</sup> Në mbrëmjen e 9 janarit 2004 vdiqën 19 shtetas shqiptarë të nisur për në Itali në një gomone për shkak të kushteve të motit të keq dhe siç raportohet për shkak të një defekti në motor. 8 persona të tjerë nuk u gjetën. Media në vend dhe jashtë tij i ka dhënë një hapësirë të gjerë kësaj tragjedie.

<sup>82</sup> Ligji Nr. 9205, i datës 15 mars 2004, që hyri në fuqi në datë 1 maj 2004.

Problemi i ndarjes së dëshmitarëve nga vëzhguesit mund të zgjidhet në qoftë se kryetari i seancës do t'i jepte personelit të policisë apo nëpunësit gjyqësor një listë të dëshmitarëve të thirrur nga prokuroria dhe mbrojtja me qëllim që të kontrolloheshin dokumentet e identifikimit, si p.sh. pasaportat, që në hyrje. Në verë, për shkak të temperaturës së lartë në sallën e gjyqit dera e hyrjes lihej e hapur nga policia – dhe si pasojë e kësaj, dëshmitarët që prisnin jashtë sallës së gjyqit mund të njiheshin me të gjithë përmbajtjen e seancës.

Në këtë kontekst duhet përmendur se mosmarrja parasyshe e kërkesave të gjykatës nga ana e dëshmitarëve nuk është domosdoshmërisht rezultat i refuzimit apo keqdashjes së dëshmitarëve, por ndonjëherë është thjesht rezultat i moskuptimit të procedurave gjyqësore. Kurrë nuk ka ndodhur që kryetari i trupit gjykues t'iu shpjegojë vëzhguesve dhe dëshmitarëve se përse prania e dëshmitarëve në sallën e gjyqit është problematike. Gjithashtu udhëzimet e detyrueshme para dëshmisë së dëshmitarit që lidhen me vërtetësinë e deklarimeve dhe ndëshkimin e dëshmive të rreme ose refuzimit për të dëshmuar,<sup>83</sup> në disa raste nuk jepen.

Dhënia e shpjegimeve të tjera shtesë do të ishte më e përshtatshme, meqenëse një numër dëshmitarësh ka një nivel mjaft të ulët arsimor e për këtë arsye ata nuk i kuptojnë qartë termat ligjore. Do të ishte e rekomandueshme që në momentin kur dëshmitarët merren në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore, t'u jepej shpjegim për fazën e ardhshme, atë të procesit gjyqësor, me qëllim që të shmangeshin keqkuptimet. Kjo do të ndihmonte edhe për diskutimin e çështjeve që shqetësojnë vetë dëshmitarin, veçanërisht ato, që lidhen me sigurinë e tij dhe atë të familjes së tij. Më pas, prokuroria do të kishte kohë të mjaftueshme për të menduar rreth masave të përshtatshme të mbrojtjes dhe pas depozitimit të akuzës, mund t'i kërkonte kryetarit të trupit gjykues, që trajtonte çështjen, konsultime ose veprime të mëtejshme të domosdoshme në lidhje me gjyqin e ardhshëm.

Kujdes i veçantë i duhet kushtuar dëshmitarëve të cënueshëm, si të miturve ose viktimave të trafikimit. Trajnimi i gjyqtarëve nga një psikolog do të ishte një ndihmë, por nga ana tjetër duhet marrë në konsideratë që, për shkak të mundësisë së zhvillimit të një seance gjyqësore për sigurimin e provës që në fazën para gjykimit,<sup>84</sup> janë shumë të rralla rastet kur grave dhe fëmijëve të trafikuar u duhet të dëshmojnë në gjyq. Nga 348 seanca të vëzhguara, në kuadrin e 58 proceseve<sup>85</sup> gjatë gjithë periudhës së vëzhgimit nga tetori 2003 deri në korrik 2004, vetëm një dëshmitare-viktimë dha dëshminë e saj në një çështje që përfshinte akuzën e trafikimit të femrave për prostitucion në bashkëpunim. Arsyeja e thirrjes së saj për të dëshmuar, pavarësisht nga provat e mëparshme, ishte se ajo kishte ndryshuar deklaratën e saj dhe ishte dënuar tashmë për dëshmi të rreme.

Mungesa e ndjeshmërisë ndaj dëshmitarëve u vu re vetëm gjatë punës së trupit të dytë gjykues të Gjykatës për Krime të Rënda, ndërsa trupi i parë gjykues u tregua shumë i aftë në këtë aspekt.

Për më tepër, siç tregohet në pikën 2.b), arranzhimet në gjykatë nuk janë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve. Në rastin e përmendur më lart me dëshmitaren-viktimë nga Kamza, trupi gjykues e la atë ballë për ballë me trafikuesit e dyshuar në sallën e gjyqit gjatë pushimit. Për më tepër, për shkak të vonesës në fillimin e seancës, prindërit e saj dhe ajo vetë ishin të detyruar të qëndronin në të njëjtin vend me miqtë dhe familjet e të pandehurit.

<sup>83</sup> Neni 305, 307 i Kodit Penal

<sup>84</sup> Neni 316-322 i Kodit të Procedurës Penale

<sup>85</sup> Trafikimi i qënieve njerëzore neni 110/a i Kodit Penal; Trafikimi i fëmijëve, Neni 128/b i Kodit Penal; Trafikimi i femrave për prostitucion, Neni 114/b i Kodit Penal;

## 8. Media

Ndryshe nga situata në vendin fqinj, në Maqedoni, ku kryetarët e gjykatave në kryeqytet nuk japin leje për të videoregjistruar seancat e gjykatës dhe televizioni në fakt nuk futet në gjykata,<sup>86</sup> në çështjet penale të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe Gjykatës për Krime të Rënda nuk është vënë re kurrë që gazetarëve tu ndalohej pjesëmarrja në një gjyq përveç çështjeve të zhvilluara me dyer të mbyllura.<sup>87</sup> Meqënëse për Gjykatën e Rrethit Tiranë mund të përdoren interneti dhe kompjuterat në hollin e ndërtesës së gjykatës, të cilët paraqesin planifikimin ditor të gjyqeve, të gjithë përfaqësuesit e medias janë në gjendje të gjejnë datën dhe orën e gjyqit, për të cilin janë të interesuar. Me kërkesën e gazetarëve, kancelari i Gjykatës për Krime të Rënda u dërgon me e-mail programin javor, i cili është gjithashtu i afishuar në një tabelë në katin e katërt të godinës së gjykatës. Më tej, shumica e gazetarëve kanë marrëdhënie të mira me policinë, kështu që atyre shpesh u jepet informacion më i saktë dhe më i azhornuar për fillimin e seancave se sa gjykatës.

Kështu, pothuajse në çdo seancë të vëzhguar në Gjykatën për Krime të Rënda ishin të pranishëm disa gazetarë, të shoqëruar pjesërisht me kameramanë. Për shkak të konkurrencës së madhe brenda një tregu të vogël,<sup>88</sup> veçanërisht media e shkruar dhe stacionet televizive fokusohen në krimet spektakolare në mënyrë që të tërheqin interesin e publikut. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë në punë, shumica e gazetarëve janë studentë. Meqënëse shpesh ata kanë punë të tjera, zakonisht ndjekin vetëm një pjesë të procesit. Njohja jo e plotë e çështjes, shoqëruar me moskuptimin dhe mospatjen e përvojës në çështjet ligjore në përgjithësi, reflektohet në artikujt, që nuk japin një informacion korrekt. Shpesh ka ndodhur që gazetarët të shikojnë shënimet e vëzhguesve, sepse nuk ishin në gjendje të ndiqnin paraqitjet e palëve në proces.

Shkrimet në media mbi një proces gjyqësor praktikisht nuk kanë asnjë kufizim, domethënë të pandehurit pas hekurave bashkë me forcat policore që i ruajnë ata, prokurorët, gjykatësit dhe dëshmitarët filmohen të gjithë dhe deklaratat e tyre regjistrohen. Emrat e dëshmitarëve, që numërohen paraprakisht gjithashtu bëhen të ditur, që do të thotë se nuk bëhet fare mbrojtja e të dhënave. Kjo rrezikon sigurinë e dëshmitarëve, gjykatës dhe personelit të policisë si dhe çënon të drejtën e personalitetit të atyre të pandehurve, që nuk janë dakort që tu botohen fotografitë dhe emrat, prandaj nevojiten urgjentisht kufizime.

Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme do të kufizonte gjithashtu edhe lirinë e veprimit të personelit të policisë për zbatimin e masave të sigurisë në lidhje me gazetarët. Dukej qartë se një numër i policëve meshkuj ishin mjaft të butë kur gazetaret femra i shpërfillnin udhëzimet e dhëna.

<sup>86</sup> Shih fq. 49, Raporti i Vleresimit të OJF-së Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta", shkruar nga Lukasz Bojarski në Qershor 2002.

<sup>87</sup> Në kuadrin e një çështjeje civile për shpifje, që i përkiste një padije të bërë nga Kryeministri ndaj një gazete, gjykatësi kompetent nuk lejoi hyrjen e personelit të OSBE-së në një seancë paraprake.

<sup>88</sup> Raporti Kombe në Tranzicion 2004 për Shqipërinë botuar nga Freedom House shkruan si më poshtë (fq.8): "Në vitin 2003 Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit raportonte se në Shqipëri ishin licensuar për transmetim 54 stacione radioje dhe 79 stacione televizioni. Kjo është një rritje në krahasim me 34 stacione radioje dhe 62 stacione televizive – duke përfshirë edhe 6 operatorë kabllorë – në vitin 2002, sipas Institutit Shqiptar të Medias. Numri i përgjithshëm i gazetave dhe revistave në 2002 ishte përkatësisht 95 dhe 70, siç raportohet nga i njëjti burim. Janë 19 gazeta të përditshme."

Meqenëse gjyqtarët në përgjithësi ngurojnë të komentojnë çështjet me gazetarët, këta të fundit fokusohen tek mbrojtja<sup>89</sup> në mënyrë që të marrin informacion shtesë. Ndërkohë avokatët mbrojtjës shpesh e shikojnë median si një mjet të mirëpritur për të reklamuar veten e tyre. Familjet e të pandehurve ose sillen në mënyrë agresive me median, sepse ata nuk duan që ata "të hedhin baltë mbi emrin e familjes së tyre" ose përpiqen ta përdorin median si një aleat në luftën kundër "drejtësisë së padrejtë". Nuk është e lehtë për gazetarët që të durojnë këtë presion, meqenëse ndërhyrja e pronarëve të gazetave kombinuar me nivelin e lartë të pasigurisë në punë, i bën ata sidoqoftë të cënueshëm.<sup>90</sup>

## II. Vendimet gjyqësore

### 1. Arsyetimi juridik

#### A) Vërejtje të përgjithshme

E drejta për një vendim të arsyetuar është pjesë e standardeve ndërkombëtare për një gjykim të drejtë. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton se gjykatat vendase arsyetojnë vendimet e tyre si për proceset civile dhe ato penale. Elementet e vendimit përshkruhen në mënyrë më specifike në nenin 383 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykatat nuk janë të detyruara që të japin përgjigje të detajuara për çdo çështje, por në qoftë se një kërkesë është themelore për përfundimin e çështjes, atëherë gjykata duhet ta trajtojë atë në mënyrë specifike në vendimin e saj.<sup>91</sup> Përndryshe nuk është e mundur për palët në proces, që të kuptojnë nëse gjykata thjesht ka neglizhuar të merret me çështjen apo synonte ta pushonte atë dhe, nëse ishte kështu, cilat ishin arsyet e pushimit.

Ashtu si edhe sjellja profesionale e gjyqtarëve ndryshon nga një gjykatës tek tjetri,<sup>92</sup> edhe cilësia e vendimeve gjyqësore ndryshon. Gjatësia mesatare e vendimeve të dhëna për çështjet e vëzhguara në Gjykatën e Rrethit Tiranë është 5 faqe. Vendimet e shpallura nga Gjykata për Krime të Rënda janë mesatarisht të gjatë 7 faqe. Vendimi më i gjatë i marrë nga Gjykata e Rrethit Tiranë ishte ai, që lidhej me "çështjen Gromi"<sup>93</sup> me 25 faqe, ndërsa më i shkurtër lidhej me një çështje penale për mbajtje të paligjshme të substancave narkotike dhe përbërje vetëm nga 2 faqe. Vendimi më i gjatë, i marrë nga Gjykata për Krime të Rënda, ishte për një çështje vrasjeje<sup>94</sup> dhe ishte i gjatë 23 faqe, kurse më i shkurtër ishte 4 faqe dhe kishte të bënte me një çështje për marrëdhënie homoseksuale me të mitur. Të dy vendimet më të shkurtra kishin të bënin me procese gjyqësore të zhvilluara në kuadrin e gjykimit të shkurtuar.

#### b) Struktura

Vendimet nuk janë të strukturuar në mënyrë uniforme, duke filluar që me faqen e parë. Në disa raste në pjesën hyrëse përmendet data e seancës së fundit, në të cilën është bërë shpallja e vendimit, ndërsa në rastet e tjera përmenden të gjitha seancat e kryera në kuadrin e procesit gjyqësor. Më tej, të dhënat personale të të pandehurit janë shpesh të paplota, p.sh. shpesh

<sup>89</sup> Ose në burimet informale brenda policisë, të cilat shpesh nuk thonë shumë.

<sup>90</sup> Raporti "Nations in Transit 2004" [Kombe në tranzicion 2004], publikim nga Freedom House, fq 9.

<sup>91</sup> Van de Hurk kundër Hollandës, 19 prill 1994, paragrafi 61.

<sup>92</sup> Shih pikën I. 5.

<sup>93</sup> Të dy të pandehurit në këtë proces të nisur nga autoritetet italiane dhe të bazuara në përmbajtjen e bisedave telefonike të përgjuara u akuzuan për krijimin e bandave të armatosura dhe organizatës kriminale, duke organizuar dhe udhëhequr organizata kriminale dhe duke prodhuar dhe shitur lëndë narkotike, neni 333, 284, paragrafi 2, 283/a, 28, 334 i Kodit Penal, "Çështja Gromi".

<sup>94</sup> "Çështja Malushi".



mungojnë vendlindja, data dhe muaji i lindjes, arsimit ose punësimi. Kjo vlen gjithashtu për të dhënat penale për shkak të mosekzistencës së një baze të dhënash kombëtare, që do të ishte e shfrytëzueshme nga çdo gjykatë. Përveç kësaj, në disa vendime nuk ishte e qartë nëse avokati ishte zgjedhur nga gjykata kryesisht apo nga vetë i pandehuri (apo familja e tij).

Dallimet e përmendura më lart u vunë re për vendime të hartuara nga e njëjta gjykatë. Ato nuk prekin vetëm pjesën operative të vendimit, por gjithashtu arsyetimin për vendimin. Një tipar i zakonshëm është gjithashtu se nuk ka ndarje apo nëndarje të tjera në tekstin e vendimeve. Vendimet e gjata, që iu referohen aktiviteteve kriminale të një game të gjërë, si ajo e "çështjes Grori", do të ishin më të lehta për t'u lexuar dhe mund të përdreshin më mirë për citime dhe referime brenda kornizës së çështjeve pasuese, në qoftë se do të ishin strukturuar ndryshe.

Në shumicën e vendimeve, arsyetimi fillon me një përmbledhje të shkurtër të historisë së procesit, ndërsa disa vendime fillojnë me kërkesën e prokurorisë në lidhje me masën e dënimit. Zakonisht, kjo kërkesë vendoset pas të dhënave personale të të pandehurit, brenda pjesës, që përfshin numërimin e veprave penale të akuzës. Vetëm pak vendime shpjegojnë historinë, që të çonte tek ngjarja, para se të fillojnë me përshkrimin e gjëndjes së fakteve, ashtu siç konsiderohen të provuara nga gjykata pas dëgjimit të provave. Përmendja e historisë së çështjes lehtëson kuptimin e çështjeve komplekse dhe duhet të jetë një pjesë integrale e vendimit.

Në pjesën e vendimit që i kushtohet vlerësimit të provave, mund të konstatohen dallimet më të dukshme. Këto – me pak përjashtime – lidhen me llojin e gjykatës, nga e cila është marrë vendimi. Gjykata për Krime të Rënda është më e plotë në arsyetimin e vendimeve të saj, meqenëse mjetet e ndryshme të provave janë<sup>95</sup> jo thjesht të numëruara, por kuptimi i tyre është i shtjelluar dhe i lidhur me pretendimet e të pandehurve. Në vendimet e hartuara nga gjyqtarët e Gjykatës së Tiranës, kjo gjë ka ndodhur rrallë.

#### c) Analiza ligjore e fakteve

Meqenëse vlerësimi i provave nga Gjykata për Krime të Rënda është më i detajuar, argumentimi i saj është më gjithëpërfshirës për lexuesin: mjetet e ndryshme të provave, përkatësisht dëshmitë e dëshmitarëve, aktet e ekspertizës, provat materiale jo vetëm numërohen, por ndikimi i tyre në argumentim vendoset në përmbajtje.

Ndryshe nga Gjykata për Krime të Rënda, Gjykata e Rrethit Tiranë nuk bën asnjë dallim për rastet kur veprimet kriminale janë më shumë se një dhe përmbushin lloje të ndryshme të veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal, të kryera nga i pandehuri gjatë ngjarjes, si dhe konkurimi ndërmjet tyre për çështjet që janë kompetencë e Gjykatës e Rrethit Tiranë.

Pjesa më e dobët e analizës ligjore të fakteve për të dy gjykatat ka të bëjë me trajtimin e çështjes së pjesëmarrjes së personave të tjerë në krim, më shpesh për formën e bashkëpunimit të tyre apo nëse i pandehuri ka marrë pjesë në organizatën kriminale.<sup>96</sup> Gjatë periudhës së vëzhgimit vetëm dy vendime lidheshin me këtë të fundit, një i hartuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë<sup>97</sup> dhe një nga Gjykata për Krime të Rënda.<sup>98</sup>

<sup>95</sup> Përveç një përjashtimi në një çështje, që përfshinte akuzën e një tentative për vrasje.

<sup>96</sup> Neni 333, 334 i Kodit Penal.

<sup>97</sup> "Çështja Grori".

<sup>98</sup> "Çështja Karajani".

Të dy të pandehurit akuzoheshin se ishin pjesë e një rrjeti që përfshinte shtetas shqiptarë dhe italianë, që trafikonin heroinën. Në "çështjen Grori" u deklarua se një nga këta italianë ishte pjesëtar i "Sacra Corona Unita", një organizatë mafioze, që vepron në Jugun e Italisë, ndërsa në "çështjen Karajani" u supozuan lidhjet e të pandehurit me organizatën mafioze Italiane e quajtur "Trento". Megjithëse në "çështjen "Grori" të dy të pandehurit u deklaruan fajtor për kryerjen e krimeve nga organizatat kriminale, vendimet nuk specifikonin madhësinë, strukturën, përbërjen dhe sfondin e organizatave kriminale, pjesë e të cilave supozohej se ishin të pandehurit. Kështu, lidhjet me "Sacra Corona Unita", dhe "Trento" mbetën të paqarta. I paqartë gjithashtu mbetet dallimi midis bashkëpunimit të thjeshtë të të pandehurve dhe krijimit të një organizate kriminale mbeten të paqarta, megjithëse kjo e fundit ka kërkesa më të larta në lidhje me kohëzgjatjen, qëllimet, strukturën, fitimin.

Elementit të bashkëpunimit shpesh i mungon gjithashtu argumentimi i mjaftueshëm, meqenëse komponenti subjektiv, përkatësisht vendimi për të kryer krimin së bashku, nuk ekziston ose shqyrtohet në mënyrë sipërfaqësore. Edhe kur gjykata mund të sigurohet pa asnjë dyshim, nga përshkrimi i ngjarjes prej të pandehurit dhe dëshmitarit, se të dy të pandehurit kanë vepruar bashkë, për vlerësimin e dënimit është e rëndësishme të vendoset se cila ishte forca shtytëse.

Çështja e lartpërmendur ilustron gjithashtu neglizhencën e përgjithshme të gjykatave në lidhje me vlerësimin nga ana e tyre të elementëve të veprës penale. Kjo ka një rëndësi shumë të madhe për dallimin e qartë midis një plagosjeje<sup>99</sup> të rëndë me qëllim, nga njëra anë dhe një vrasjeje<sup>100</sup> me qëllim apo një vrasje<sup>101</sup> të paramenduar nga ana tjetër. Në vendim shpesh deklarohen thjesht fakte, përkatësisht që i pandehuri qëllon viktimit dhe shkaktoi një plagë në stomakun e viktimit apo se plagosjet e brëndshme, që rezultuan nga goditjet çuan në rrezikimin e jetës së viktimit. Sidoqoftë, ky argument nuk e përcakton qëllimin e të pandehurit. Një vlerësim i tillë nuk do të kishte qenë madje as i mundshëm nga gjykata, sepse i pandehuri nuk u pyet në këtë aspekt gjatë seancave.

## II. Vlerësimi i llojit dhe masës së dënimit

### a) Vërejtje të përgjithshme

Në përgjithësi vlerësimi i dënimit është disi sipërfaqësor për dy arsye. Së pari, personaliteti i të pandehurit nuk i nënshtrohet një shqyrtimi të kujdesshëm nga ana e gjykatës. Vetë vendimi thjesht deklaron disa të dhëna personale,<sup>102</sup> nuk ka të bashkëlidhur një histori të jetës apo një *curriculum vitae* të të pandehurit, megjithëse informacioni shtesë do të ishte me vlerë në caktimin e masës së dënimit. Për më tepër, gjykata do të ishte në gjëndje të zbulonte shqetësimet mendore të të pandehurit në një fazë të hershme të gjykimit dhe për pasojë mund të fillohej ekzaminimi i nevojshëm psikiatrik apo dhe psikologjik dhe eventualisht masat e sigurisë mund të ndryshoheshin.

E dyta, pavarësisht nga fakti që Kodi Penal ofron një gamë të gjërë të llojeve të dënimeve të tilla si burgosja,<sup>103</sup> gjoha,<sup>104</sup> ndëshkime suplementare<sup>105</sup> si dhe masa mjekësore dhe edukative,<sup>106</sup>

<sup>99</sup> Neni 88 i Kodit Penal.

<sup>100</sup> Neni 76, 77, 79 i Kodit Penal.

<sup>101</sup> Neni 78 i Kodit Penal.

<sup>102</sup> Emrin, emrin e prindit, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin, gjendjen civile, arsimin, profesionin, gjendjen gjyqësore.

<sup>103</sup> Neni 32 i Kodit Penal.

<sup>104</sup> Neni 34 i Kodit Penal.

<sup>105</sup> Neni 35-42 i Kodit Penal.

që lidhen me persona të papërgjegjshëm apo të mitur, shumica e dënimeve janë me burgim.<sup>107</sup> Sipas analizës së gjashtëmujorit të parë të vitit 2004 të Prokurorisë së Përgjithshme, vendimet e Gjykatës së Rrethit për burgim përbëjnë 58,9 % të dënimeve dhe 60,2% të pretendimeve të organit të prokurorisë. Në lidhje me Gjykatën për Krime të Rënda, të pandehurit nuk u deklaruan të pafajshëm në asnjë prej 20 çështjeve të përfunduara. Për shkak të kufizimit të juridiksionit të gjykatës në vepra penale me një dënim minimal prej 15 vitesh, të gjitha dënimet janë me burgim, që variojnë nga 3 vjet e 8 muaj dënim me burg<sup>108</sup> deri në burgim të përjetshëm.<sup>109</sup> Dënimi mesatar i të pandehurve nga Gjykata për Krime të Rënda ka qenë 15 vjet e 1 muaj burgim.

b) Rrethanat lehtësuese/rënduese

Për të vendosur një masë dënimi, nga Neni 48 deri në nenin 50 të Kodit Penal citohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese që gjyqtarët duhet të marrin në konsideratë, kur vendosin për një dënim. Në nenin 50 të Kodit Penal, nuk flitet nëse renditja e rrethanave ka natyrë përmblylëse apo jepet si shembull.<sup>110</sup> Kështu, në disa vendime të shqyrtuara përmenden fakte që nuk mbulojnë nga dispozitat e lartpërmendura. Për shembull, disa vendime përmendnin moshën e dëshmitarit apo gjendjen civile. Nuk ishte gjithmonë e qartë nga konteksti, nëse kjo vlerësohej si një rrethanë lehtësuese apo rënduese dhe përse.

c) Dënimet shtesë

Pavarësisht nga çështjet e shumta, që përmbajnë akuzën e trafikimit, një aktivitet mjaft me fitim ky, vetëm Gjykata për Krime të Rënda e përdori mundësinë e vendosjes së një gjobe shtesë për autorët e krimit, siç parashikohet në Nenin 34 të Kodit Penal. Mosshpjegimi i shumës së vendosur ndoshta vjen për shkak të mungesës së përvojës në zbatimin e kësaj dispozite. Sipas ligjit, gjykata mund të vendosë një gjobë shtesë prej 100.000 deri në 5.000.000 lekë. Nxjerrja e kritereve nga Ministria e Drejtësisë për të shërbyer si një orientim për vendimet e marra nga gjykata do të kufizonte të drejtën e vendimit të gjyqtarëve dhe për pasojë do të parandalonte vendimet arbitrare. Kjo gjithashtu vlen dhe për çështjet e padive civile, kur ato kombinohen me procese penale.<sup>111</sup>

### III. Llojet e veprave penale të gjykuara

Vrasja dhe implikimi në trafikun e qenieve njerëzore dhe trafikimin e drogës përfaqësojnë pjesën më të madhe të krimeve kryesore të hetuara nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe të gjykuara nga Gjykata për Krime të Rënda. Gjysma e 200 çështjeve të hetuara gjatë pjesës së

<sup>106</sup> Neni 46 i Kodit Penal.

<sup>107</sup> Studimi i fundit i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve zbulon se 1 në 400 shqiptarë është në burg, që është shifra më e lartë e raportuar në 14 vitet e fundit. Më konkretisht një total prej 9000 shqiptarësh vuajnë burgimin në Shqipëri, Itali, Greqi dhe vende të tjera. Nga ata, rreth 3500 janë në burgjet shqiptare.

<sup>108</sup> I pandehuri ishte një i mitur, që u gjykua në kuadrin e një gjyqi të shkurtuar. Meqenëse dispozitat e Kodit Penal (Neni 51 i Kodit Penal), Neni 406, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale), parashikojnë një reduktim të dënimeve deri në gjysëm për të miturit dhe një të tretën e dënimit për personat e gjykuar me gjykim të shkurtuar, dënimi i fillimit u reduktua në 3 vjet e 8 muaj.

<sup>109</sup> Dy të pandehur u dënuan me burgim të përjetshëm për vrasje për shkakun e cilësive të veçanta të viktimës, Neni 79 c i Kodit Penal. Një prej tyre ishte i pandehuri Agim Pepa, i cili u gjet fajtor në vrasjen e shefit të komisarit të Krujës Gani Malushi.

<sup>110</sup> Ndërsa Neni 49 deklaroi se pavarësisht nga rrethanat e përmendura në Nenin 48 të Kodit Penal, Gjykata mund të konsiderojë gjithashtu rrethana të tjera për sa kohë që ajo i gjykon ato të arsyeshme për të justifikuar uljen e një dënimi.

<sup>111</sup> Neni 58-68 i Kodit të Procedurës Penale

parë të vitit të punës nga Prokuroria për Krime të Rënda ishin vrasjet, ndërsa pjesa tjetër ndahet në krime trafikimi dhe grabitje me armë.

Nga 81 çështje të dërguara për gjykim në Gjykatën për Krime të Rënda në periudhën e raportimit, 36 çështje lidheshin me akuza për vrasje, 18 për grabitje me armë dhe 12 me vepra penale të trafikimit. Proceset e vrasjes të ndjekura nga vëzhguesit në gjykatë, kryesisht lidheshin me nevoja materiale, grindje për prona ose ishin rezultat i marrëdhënieve personale antagoniste. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre çështjeve ishin mjaft të vjetra dhe bënin fjalë për ngjarje të ndodhura gjatë trazirave të vitit 1997. Prandaj vërtetimi i provave është i vështirë meqenëse dëshmitarët kanë emigruar, vendndodhja e tyre është e panjohur ose ata nuk i mbajnë mend qartë ngjarjet. Për më tepër, përdorimi i akteve të ekspertizës është i kufizuar, meqenëse ekspertiza balistike nuk ekzistonte në vitin 1997 dhe analiza e ADN nuk mund të kryhet akoma në polici. Kjo ndërlikon vendosjen e drejtësisë nga ana e gjykatës dhe i stërgjat proceset.

Ndryshe nga kjo, autorët e vjedhjeve me armë shpesh janë të rinj nga zonat rurale. Shumica e tyre identifikohen relativisht lehtë nga policia dhe e pranojnë fajin. Prandaj shumica e çështjeve të tilla gjykohe në kuadrin e një gjyqi të shkurtuar.

Çështjet e krimit të organizuar zakonisht lidhen me veprat penale të trafikimit. Për shkak të përfshirjes së vendeve të huaja, qëndrimit mohues të kriminelëve dhe caktimit të avokatëve të mbrojtjes që "bombardojnë" gjykatën me kërkesa, këto procese janë më të gjatat.<sup>112</sup>

## **F. REFLEKTIME PËR ÇËSHTJET E KRIMIT TË ORGANIZUAR**

### **I. Statistika**

Gjashtë muajt e parë të vitit 2004 kanë parë një rritje në ndjekjen e çështjeve të krimit të organizuar. Në të dhënat e fundit statistikore, të dhëna nga Prokuroria e Përgjithshme,<sup>113</sup> prokuroria identifikoi 867 çështje me 769 të pandehur të akuzuar për përfshirje në krimin e organizuar, trafikimin e paligjshëm dhe korrupsion. Krahasuar me vitin 2003, Prokuroria e Përgjithshme regjistroi një rritje 36,9 % të proceseve dhe 52,5 % të të pandehurve. U regjistrua gjithashtu një rritje prej 50 % në lidhje me akuzat (që arrijnë në total 360) dhe 25 % në lidhje me numrin e personave të dënuar. 14 çështje penale u ndoqën me 30 të pandehur për çështjet e krimit të organizuar të lidhura me organizata kriminale, nga të cilat 11 akuza janë depozituar në gjykatë, 2 prej tyre përfunduan me dënime dhe 9 të tjera janë në procesin e gjykimit.

### **II. Studim çështjesh**

Gjatë periudhës së raportimit në Gjykatën e Rrethit të Tiranës u vëzhgua vetëm një çështje<sup>114</sup> me akuzën e krijimit të një bande të armatosur apo të një organizate kriminale<sup>115</sup> ose kryerjen e krimeve brenda një bande të armatosur apo një organizate kriminale,<sup>116</sup> ndërsa në Gjykatën për

<sup>112</sup> Shih pikën C.I.4.

<sup>113</sup> "Informacion për treguesit kryesorë të punës së Prokurorisë dhe gjëndja e përhapja e kriminalitetit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004" nga Prokuroria e Përgjithshme për Ambasadorin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, datë 30 korrik 2004, fq.7.

<sup>114</sup> "Çështja Grori".

<sup>115</sup> Neni 333 i Kodit Penal.

<sup>116</sup> Neni 334 i Kodit Penal.

Krime të Rënda u gjykuan 4 çështje që lidheshin me këtë akuzë. Një nga këto çështje është përfunduar, ndërsa të tjerat janë në proces.

Përkatesisht tri nga katër çështje<sup>117</sup> lidhen me trafikimin e drogës.<sup>118</sup> Të gjitha çështjet e trafikimit kishin nisur në Itali dhe provat ishin të bazuara në përgjimet telefonike të bëra nga autoritetet italiane. Kjo pasqyron qartë nevojën për masa të veçanta hetuese në mënyrë që të mundësohet zbulimi i rrjeteve të trafikimit, që veprojnë në Shqipëri. Kjo jo vetëm presupozon një kuadër legjislativ, që të lejojë përgjimin e telekomunikimeve dhe komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, duke regjistruar biseda telefonike<sup>119</sup> të bëra nga një numër telefoni i caktuar pa dijeninë apo pëlqimin e personit ndaj të cilit merret kjo masë, infiltrimin e agjentëve të kamufluar dhe zbulimin e të dhënave financiare, por gjithashtu kërkon pajisje të domosdoshme të teknologjisë së informacionit si dhe trajnim të personelit, që të përgjigjet për zbatimin e këtyre masave. Në veçanti, në fushën e organizatave kriminale, shpesh nuk janë të mjaftueshme provat, që bazohen vetëm në dëshminë e dëshmitarit, meqenëse drejtuesit e këtyre organizatave zakonisht veprojnë në prapaskenë dhe prandaj kontributi i tyre është vështirë të zbulohet.

Në fakt grupet e krimit të organizuar janë duke u bërë gjithnjë e më të zhdërvjelltë dhe tentojnë të përfshihen në një gamë aktiviteteve kriminale, në varësi të mundësive.<sup>120</sup> Për shembull, një i pandehur u akuzua si pjesëmarrës në vrasjen e dy bashkëpunëtorëve si rezultat i një grindjeje, që lindi nga shitja e 9 kg. heroine të një cilësie të dobët. Ky i pandehur u deklarua i pafajshëm,<sup>121</sup> lidhja e aktiviteteve të tij kriminale mbeti e panjohur, megjithëse gjatë kohës së gjykimit përgjimi telefonik i kryer nga autoritetet italiane tashmë ishte përfunduar. Edhe njëherë, kjo tregon nevojën e shkëmbimit më të mirë të informacionit midis Shqipërisë dhe vendeve të saj fqinje. Për më tepër, këto dy studime të çështjeve verifikojnë bashkëpunimin e grupeve etnike shqiptare të krimit të organizuar, të cilat përdorin dhunë ekstreme gjatë trafikimit të qenieve njerëzore dhe të drogës.<sup>122</sup>

### III. Veçanti të çështjeve të trafikimit të drogës

Në të gjitha çështjet e gjykuara për trafikimin e drogës, droga e trafikuar ishte heroina. Kjo përputhet me Raportin Botëror për Drogën 2004 të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogën, i cili thotë se kultivimi i paligjshëm i hashashit në Afganistan u rrit edhe pas ndalimit të hashashit nga regjimi taliban. Si rrjedhim, trafikimi i heroinës mori një shtysë të re dhe parashikohet të rritet për shkak të mbjelljeve të mëdha të hashashit, që priten në Afganistan, duke rritur nivelet e kultivimit aktual.<sup>123</sup>

Meqë shumica e heroinës të destinuar për Europën perëndimore lëviz në rrugët e Ballkanit,<sup>124</sup> Shqipëria ka gjasa të vazhdojë të jetë një vend tranziti. Rreth 43% e substancave narkotike, veçanërisht heroinës që arrijnë në Itali, dyshohet se kalojnë përmes Shqipërisë. Qendrat

<sup>117</sup> 1 në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe 3 në Gjykatën për Krime të Rënda.

<sup>118</sup> 1 në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe 2 në Gjykatën për Krime të Rënda.

<sup>119</sup> D.m.th. numri i thirrur/i telefonuar dhe kohëzgjatja e bisedës.

<sup>120</sup> Europol, raporti për krimin e organizuar i Bashkimit Evropian 2003, fq.9.

<sup>121</sup> Në një vendim prej 4 faqesh, megjithëse i pandehuri u provua të ishte i pranishëm në vendin e ngjarjes në momentin e ngjarjes.

<sup>122</sup> Europol, raporti për krimin e organizuar i Bashkimit Evropian 2003, fq.14.

<sup>123</sup> UNODC, World Drug Report 2004 [Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogën, "Raport botëror për drogën 2004"], Volumi 1, fq. 59/60.

<sup>124</sup> UNODC, World Drug Report 2004 [Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogën, "Raport botëror për drogën 2004"], Volumi 1, fq. 71.

kryesore të trafikimit të drogës janë identifikuar se janë Tirana, Durrësi, Fieri, Vlora, Elbasani dhe Laçi.

Tendenca për një trafikim të shumë drogave nga grupet e krimit të organizuar<sup>125</sup> deri tani nuk është pasqyruar në çështjet për gjykim, megjithatë, shuma e kapur kohët e fundit prej 10 kg. kokainë, më e madhja në historinë e Shqipërisë, tregon ekzistencën e aktiviteteve të trafikimit të kokainës në vend, siç tregojnë shifrat në raportin vjetor të Drejtorisë Qendrore Italiane kundër drogës në Ministrinë e Brëndshme Italiane, sipas të cilit 190 shtetas shqiptarë u arrestuan në Itali me akuzën për trafikim kokaine apo si anëtarë të grupeve të organizuara të trafikimit të kokainës.<sup>126</sup>

Lidhjet midis organizatave kriminale me bazë në Itali dhe Shqipëri, të krijuara nga emigrantët shqiptarë në Itali, janë vënë në dukje në gjitha çështjet gjyqësore të përmendura më sipër lidhur me trafikimin e organizuar. Shkalla më e lartë e bashkëpunimit ilustron fakti që në dy çështje gjyqësore, pjesëtarët italianë të rrjetit u konsideruan si pjesë e grupeve të tilla të mirënjohura Mafioze si "Sacra Corona Unita" dhe "Trento", që kishin bashkëpunëtorë brenda radhëve të policisë Italiane. Në këto dy çështje dyshohej se të akuzuarit shqiptarë kishin kryer vrasje në kuadrin e aktiviteteve të tyre kriminale, por provat nuk u konsideruan të mjaftueshme. Në Belgjikë vazhdonte një proces gjyqësor kundër një të pandehuri, akuzuar për vrasjen e të dashurës së tij. Sipas familjarëve të saj, i akuzuari ishte i përfshirë gjithashtu në trafikimin e qënieve njerëzore dhe shfrytëzimin e femrave për prostitucion.

## **G. REKOMANDIME**

### **Organizimi i Gjykatës**

#### **- E drejta për një seancë publike; e drejta për t'u gjykuar pa vonesa të panevojshme.**

- Gjyqet nuk duhet të planifikohen vetëm për në mëngjes, por edhe për pasdite. Kjo do ta bënte më të lehtë për gjykatën që t'u përmbahej afateve dhe të respektonte planifikimin.
- Kancelari duhet të bëjë një vlerësim më realist të kohëzgjatjes së seancës, bazuar në numrin e të pandehurve, avokatëve të mbrojtjes, dëshmitarëve si dhe proceseve gjyqësore. Që të arrihet kjo, kërkohet një komunikim më i mirë me kryetarin për shkëmbimin e informacionit.
- Veç planifikimit javor, në dyert e sallave të gjyqit duhet të vendoset informacion shtesë në lidhje me seancat ditore, orën e seancës, emrin e të akuzuarve dhe veprën penale.
- Një zyrë informacioni mund të krijohet në Gjykatën për Krime të Rënda, e cila do të informonte lidhur me vonesat e seancave dhe do të azhurnonte planifikimin javor si dhe t'u përgjigjej kërkesave të publikut.

#### **- E drejta për të thirrur dhe për të ekzaminuar dëshmitarët ; e drejta për një seancë të drejtë gjyqësore.**

- Duhet të krijohet një dhomë pritjeje e veçantë për dëshmitarët ose duhet të bëhen rregullime të tilla që të shmangen konfrontimet mes tyre dhe familjeve të të pandehurve,

<sup>125</sup> Europol, raporti për krimin e organizuar i Bashkimit Evropian 2003, fq.14.

<sup>126</sup> "2003 Il contrasto al traffico illecito di sostanze stupefacenti" [2003 Lufta kundër trafikut të paligjshëm të substancave narkotike].

ndërkohë që dëshmitarëve duhet t'u mundësohet që të përdorin hyrjen/daljen e dytë të rezervuar për personelin e gjykatës.

- Një listë e dëshmitarëve të thirrur për të dëshmuar nga prokuroria dhe mbrojtja duhet t'u dorëzohet ose policëve që bëjnë kontrollet e sigurimit në hyrje ose nëpunësve gjyqësorë përpara hapjes së seancës, në mënyrë që të shmangët ndjekja e procesit nga dëshmitarët dhe të mos privohet gjykata nga mjetet e çmuara të provave.
- Duhet të bëhen rregullimet e duhura në sallën e gjyqit duke iu përshtatur tipareve të procesit. Këto duhet të marrin në konsideratë numrin e pjesëmarrësve, komunikimin midis të pandehurve dhe avokatëve, barazinë e mjeteve lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarëve si dhe masat e sigurisë. Në mënyrë që të arrihet një marrëveshje për këtë, duhet të mbahen mbledhje të rregullta nga ana e personelit të gjykatës ku duhet të marrë pjesë edhe forcat e policisë, të cilët përgjigjen për ruajtjen e sallës së gjyqit.

#### **Kuadri ligjor**

- Duhet të hartohet një rregullore e brendshme në mënyrë që të shmangen rivalitetet midis gjyqësorit dhe policisë në lidhje me masat e sigurisë dhe për të shmangur vendimet arbitrare. Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës duhet të angazhohen seriozisht për hartimin e kësaj rregulloreje, meqenëse këta e njohin më shumë praktikën dhe prandaj mund të bëjnë një vlerësim më të orientuar bazuar në objektivat.
- Rregullorja e brendshme duhet të përfshijë të drejtat dhe kufizimet e medias, që lindin nga bashkëveprimi i të drejtave të të pandehurve dhe dëshmitarëve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe sigurisë personale. Në veçanti, duhet të përfshihen kufizimet në lidhje me regjistrimin e seancave si dhe rregullat për publikimin e emrave dhe fotografive të të pandehurve dhe dëshmitarëve.
- Mosparaqitja e prokurorëve dhe avokatëve në gjyq pa justifikim të mjaftueshëm duhet t'i nënshtrohet sanksioneve në mënyrë që të parandalohen vonesat e panevojshme dhe të sigurohet përfundimi i gjyqit në kohën e duhur. Këto masa mund të futeshin në Kodin e Procedurës Penale,<sup>127</sup> Ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë" ose në Kodin e Etikës për Avokatinë.
- Meqenëse një numër i konsiderueshëm i shtyrjeve shkaktohen nga moshoqërimi i të pandehurve nga dhomat e paraburgimit për në gjykatë, transferimi i përgjegjësive nga Ministria e Rendit Publik në Ministrinë e Drejtësisë duhet të përfundohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe duhet të caktohen burimet e përshtatshme njerëzore dhe materiale për transportimin e të pandehurve. Më tej, ndërtesa e re e Gjykatës për Krime të Rënda duhet të përfshijë qelitë për të pandehurit në mënyrë që të shkurtohen orët e pritjes dhe të lehtësohen rregullimet për transportimin kolektiv.

#### **Drejtësia e të miturve**

##### **- E drejta për të qenë i pranishëm në gjyq dhe për të apeluar; e drejta për një seancë të drejtë gjyqësore**

- Përdorimi i gjykimeve të shkurtuara të cilët përbëjnë 56 % të proceseve penale,<sup>128</sup> duhet të përjashtohen për të pandehurit e mitur, meqenëse ata nuk kanë gjasë që të kuptojnë pasojat e kësaj procedure, veçanërisht lidhur me mundësitë e kufizuara të mbrojtjes. Më tej, krimet e rënda si çështjet e vrasjeve duhet gjithashtu të përjashtohen nga kjo

<sup>127</sup> Bosnja' Hercegovina e ka zgjidhur problemin në këtë mënyrë.

<sup>128</sup> Kjo shifër u dha në "Informacion për treguesit kryesorë të punës së prokurorisë dhe gjendja e zgjerimi i kriminalitetit gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2004" nga Prokuroria e Përgjithshme për kreun e OSBE në Shqipëri, datë 30 korrik 2004.

procedurë, meqenëse shqyrtimi gjyqësor duhet të jetë sa më i kujdesshëm që të jetë e mundur, duke patur parasysh rrezikimin e të pandehurit.

Për shembull, nëse trupi gjykues nuk krijon një përshtypje personale në lidhje me një dëshmitar, dëshmia e të cilit është vendimtare për vërtetimin e provave, është pothuajse e pamundur të vlerësohet besueshmëria e tij. Prandaj, në kuadrin e gjykimit të shkurtuar duhet të gjykohen vetëm proceset, që lidhen me shkelje, të cilat kanë deklarim të thjeshtë të fakteve dhe të pandehur të rritur, që e kanë pranuar kryerjen e krimit.

- E njëjta gjë vlen dhe për gjyqet në mungesë. Gjykimet pa praninë e të pandehurve bëhen ose sepse nuk dihet vendndodhja e të pandehurit dhe ai për pasojë deklarohet në mungesë, ose sepse ata bazohen në një kërkesë nga ana e të pandehurit, i cili nuk dëshiron të marrë pjesë në gjykim. Mundësia e fundit nuk duhet të zgjidhet në rastin e të miturve, meqenëse është e qenësishme të njihet personaliteti i të pandehurit, në mënyrë që të mundësohet përcaktimi i saktë i masës së dënimit. Kjo do të marrë edhe më shumë rëndësi pas miratimit të paketës ligjore të drejtësisë për të miturit, e cila parashikon masa edukative në vend të dënimeve me burg për të miturit.

### **Profesionalizmi**

- Gjyqtarëve iu nevojitet trajnim për marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Kjo ka rëndësi të veçantë në lidhje me grupet e dëshmitarëve veçanërisht të cënueshëm, të tillë si dëshmitarët/të dëmtuarit, fëmijët, të miturit dhe njerëzit me shqetësime mendore. Prokurorët - kryesisht ata që nuk e kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës - priren të bëjnë pyetje sugjestive dhe për pasojë dështojnë në përpjekjet e tyre për të nxjerrë informacionin e kërkuar për vërtetimin e provave.
- Për të përmirësuar marrëdhëniet me median duhet të emërohet një zëdhënës për prokurorinë dhe për gjykatën. Shpesh, magjistratët reagojnë në mënyrë shumë të rezervuar kur pyeten nga përfaqësuesit e medias, ngaqë iu mungon përvoja e trajtimit të gazetarëve dhe kanë frikë se mos krijojnë një imazh të keq për gjykatën apo prokurorinë. Gjithashtu, do të ishte e papërshtatshme që ata të diskutonin disa çështje me median. Për pasojë, media përpiqet që të marrë të dhëna në mënyrë indirekte, mundësisht duke përdorur mjete të diskutueshme, dhe këto të dhëna nga vetë natyra e tyre mund të rezultojnë në një informacion të publikuar të pasaktë.
- Kërkohet ekspertizë më e madhe që gjykata të kalojë nga përdorimi i dëshmimeve të dëshmitarëve në përdorimin e provave materiale, që rezultojnë nga masa të posaçme hetuese.

Për shembull, në një proces në të cilin provat bazoheshin kryesisht në përgjime telefonike të autoriteteve italiane, i dyshuari kryesor mohoi se kishte folur në telefon. Prandaj, do të kishte qenë e domosdoshme një analizë e zërit, e cila nuk mund të bëhet në Shqipëri. Prandaj, gjyqtarit iu nevojiti të kontaktonte homologët italianë që të emëronin një ekspert italian, gjë që shkaktoi vonesa të mëtejshme gjatë hetimeve.

- Duhet të krijohet një model uniform për vendimet gjyqësore. Kjo do të siguronte kompletimin e të dhënave personale të të pandehurit dhe do të ndihmonte në përmirësimin e argumentimit. Për pasojë, do të reduktoheshin gabimet procedurale që çojnë në prishjen e vendimeve nga apeli.



- Në mënyrë që të përmirësohet cilësia e vlerësimit të llojit dhe masës së dënimeve, trupi gjykues duhet të shqyrtojë më tërësisht personalitetin e të pandehurit, d.m.th të marrë në pyetje të pandehurin në mënyrë të detajuar. Kjo do të ndihmonte gjithashtu për të nisur ndonjë ekspertizë eventuale psikiatrike apo dhe psikologjike në një fazë të hershme të gjykimit.
- Duhet ngjeshur procesi në mënyrë që të shmangët shkelja e të drejtës së të pandehurit për të gjykuar brenda një kohe të arsyeshme. Prandaj, ashtu siç është praktikuar në disa raste, prokurori duhet të jetë në gjendje që të zëvendësohet nga një koleg. Në qoftë se avokati i mbrojtjes nuk është në gjendje që të ndjekë një seancë gjyqësore, gjykata duhet të përdorë më tepër fuqinë e saj për të caktuar një zëvendësim me avokat të caktuar kryesisht. Për më tepër, konkluzionet përfundimtare të prokurorisë dhe mbrojtjes mund të jepeshin në të njëjtën seancë. Për kërkesat mund të vendosej pas një pushimi, në vend që të shtyhej seanca.
- **E drejta për një vendim të arsyetuar**
- Vendimet gjyqësore duhet të përmbajnë më shumë argumente në mënyrë që të shpjegojnë se si i arriti konkluzionet gjykata, duke marrë parasysh gjithashtu deklaratat dhe kërkesat e bëra nga mbrojtja. Kjo mund të reduktonte numrin e apeliemeve, meqë prokuroria dhe mbrojtja do të ishin në gjendje të vlerësonin më mirë suksesin e një apeli, gjë që në disa raste mund të çojë në përfundimin e çështjes, meqenëse vendimi fillestar do të bëhej përfundimtar.

## H. PERSPEKTIVA

Zhvillimet e fundit tregojnë që situata në lidhje me burimet njerëzore në Gjykatën për Krime të Rënda mund të qetësohet, por Gjykata mund të vazhdojë të vuajë nga kushtet e papërshtatshme të punës. Thashethemet që qarkullojnë tashmë në media për një rritje të numrit aktual prej 11 gjyqtarësh (duke përfshirë kryetarin) janë konfirmuar nga kryetari. Thuhet se ka filluar procesi i rekrutimit të pesë gjyqtarëve shtesë. Kjo do të thoshte që gjykata do të ishte në gjendje të formonte një trup gjykues të tretë në të ardhmen e afërt, siç është parashikuar në fillim nga plani për personelin, hartuar nga Ministria e Drejtësisë. Prandaj kjo mund të çojë në një reduktim të çështjeve të papërfunduara.

Eshtë caktuar një sallë gjyqi e tretë për Gjykatën për Krime të Rënda nga Gjykata e Rrethit Tiranë, në mënyrë që të mundësojë kryerjen e seancave nga të tre trupat gjykues në të njëjtën kohë. Gjykata ka kërkuar dy zyra të tjera në ndërtesë për personelin shtesë. Kjo do të nënkuptonte më pak hapësirë për personelin në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Në mënyrë që të krijohen kushte pune më të përshtatshme për të dy gjykatat, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda do të lëvizë përkohësisht në një ndërtesë në zonën e burgut 313 gjatë vitit tjetër, deri në përfundimin e ndërtimit të një gjykate të re për të gjithë organet<sup>129</sup> e Krimeve të Rënda, financuar nga BE në kuadrin e programit CARDS.

Meqenëse fondet e parashikuara në buxhetin përfundimtar gjyqësor për 2005 për pajisjen e Gjykatës për Krime të Rënda, nevojiten për rinovimin e akomodimit të përkohshëm, duket

<sup>129</sup> Prokuroria për Krime të Rënda, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

qartë se burimet financiare nuk do t'i plotësojnë nevojat materiale. Për më tepër, për shkak të vendndodhjeve të ndryshme të Prokurorisë, Gjykatës së Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit dhe madje distancës më të madhe pas lëvizjes së Gjykatës për Krime të Rënda në Gjykatën e Shkallës së Parë, komunikimi do të jetë më i vështirë, veçanërisht, meqenëse personeli nuk ka akses në internet dhe duhet të përdorë të njëjtat telefona.

Nga ana tjetër, vendndodhja e re do të zvogëlojë vonesat e shkaktuara nga rregullimet për transportimin e të pandehurve me masë sigurie arrest me burg, të cilët mbahen në burgjet e Tiranës. Mbetet për t'u parë se si do ta trajtojnë situatën palët e tjera të gjykimit (d.m.th. prokurorët dhe avokatët e mbrojtjes).

Ndikimi që do të kenë në punën e Gjykatës për Krime të Rënda ndryshimet strukturore dhe logjistike të planifikuara do të pasqyrohet në raportin përfundimtar, që do të nxirret pas përfundimit të programit në dhjetor 2005.

***Për më shumë informacion për projektin kontaktoni:***  
*Ama Kraja, Asistente e Drejtuesit të Projektit për Prokurorinë dhe Gjykatat*  
*Departamenti i Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut*  
*Prezenca e OSBE-së në Shqipëri*  
*Rr. "Donika Kastrioti", Vila 6*  
*Tirana, ALBANIA*  
*e-mail: Ama.Kraja@osce.org*